



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## **RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK**

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në  
“Inxhinieri Mekatronike”  
në Universitetin Privat “Albanian University”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof.Asoc.Dr.Mimoza Cukalla

2. Dr.Thomaq Koblara

Dhjetor 2020

**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**  
**Për Programin e studimit: Bachelor në Inxhinieri Mekatronike**

|      |   |  |
|------|---|--|
| Nr.  |   |  |
| 1    | IAL aplikues:   | Universiteti Privat “Albanian University”  |
| 2    | Njësia bazë që e ofron:                                   | Departamenti i Inxhinierive, (Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike)  |
| 3    | Emërtimi i programit të studimit:                         | Bachelor në Inxhinieri Mekatronike   |
| 4    | Urdhëri/VKM i licencimit:                                 | Urdhër i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 488, datë 04.10.2011  |
| 5    | Urdhëri/VKM i riorganizimit:                              | -  |
| 6    | Urdhëri i regjistrimit të Formës së diplomës:             | UMAS Nr 631, datë 12.12.2017   |
| 7    | Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:                        | Akreditimi me kusht: UMAS Nr. 436, datë 25.08.2016, bazuar në VKA Nr. 179, datë 07.07.2016<br><br>Akreditimi i parë: VBA Nr. 51, datë 10.07.2017 (vlefshmeria e akreditimit: 31.07.2020; kohezgjatja 3 vite akademike) |
| 8    | Cikli i studimit:   | Cikli I  |
| 9    | Kohëzgjatja e programit të studimit:                      | 3 vite akademike   |
| 10   | Kreditet në total (ECTS):                                 | 180 ECTS   |
| 11   | Forma e studimit:   | Me kohë të plotë   |
| 12   | Gjuha (shqip/tjetër):                                     | Shqip  |
| 13   | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera: | JO   |
| 13.1 | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):                   | -  |
| 13.2 | Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):                     | -  |
| 14   | Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:            | Niveli 6   |
| 15   | Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:          | <b>16 PAE (7 Dr., 2 Dr. Proc. dhe 7 MSc)</b><br><b>16 PAK (1 Prof., 6 Prof. Assoc., 6 Dr., 2 Dr. Proc. dhe 1 MSc).</b>   |
| 16   | Numri i studentëve:                                       | 83 në vitin akademik 2019-2020   |
| 17   | Komente / të tjera:                                       |  |

## TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit **Bachelor në “Inxhinieri Mekatronike”**, që ofrohet nga Universiteti Privat “Albanian University” është licencuar me Urdhër të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës Nr. 488, datë 04/10/2011, pasi ka marrë vlerësim pozitiv, me sugjerime nga Këshilli i Akreditimit, VKA Nr.241, datë 16.09.2011. Fillimisht ky program studimi është ofruar nga departamenti i Elektronikës. Në vitin 20016, programi i studimit kalon në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, nën përgjegjësinë e Departamentit të Inxhinierive, si rezultat i riorganizimit të universitetit, në bazë të: Urdhërit të MAS Nr. 52, datë 05.02.2016.

Me Urdhër të MAS Nr.436, datë 25.08.2016 programi ka marrë akreditimin e parë, me kusht dhe me Vendim të Bordit të Akreditimit VBA Nr.51 dt. 10.07.2017 programi ka fituar akreditimin e parë pozitiv me kohëzgjatje 3 vite akademike (afati deri më 31.07.2020)

Bazuar në dokumentacionin e ofruar si dhe në raportin e vlerësimit të brendshëm rezulton se programi i studimit *Bachelor* në “Inxhinieri Mekatronike”, është program studimi i ciklit të parë dhe i përket nivelit të 6<sup>të</sup> të kualifikimit sipas kornizës Shqiptare të Kualifikimit. Kohëzgjatja normale e programit të studimit është 3 vite, dhe përkon me 180 kredite. Kjo kurrikul i përket formës së studimit me kohë të plotë dhe zhvillohet në gjuhën shqipe.

Programi i studimit *Bachelor* në “Inxhinieri Mekatronike” ka si qëllim të hedhë bazat e nevojshme teoriko - praktike për ushtrimin e profesionit të inxhinierit në fushën e mekatronikës, i cili do të kontribuojë në drejtim të mirëmbajtjes apo të prodhimit të sistemeve mekatronike.

Kjo përgatitje e përgjithshme gjatë periudhës trevjeçare u krijon mundësinë studentëve të integrohen në tregun e punës dhe gjithashtu, formon bazat e nevojshme për të thelluar studimet dhe për të përfituar kompetenca më specifike mbi tema më të profilizuara që mund të trajtohen gjatë studimeve të specializuara.

Për realizimin e këtij qëllimi, kurrikula është organizuar në mënyrë të tillë, që në vitin e parë t’iu ofrojë studentëve njohuritë bazë shkencore, mbi të cilat do të ngrihen në dy vitet e tjera njohuritë që përkojnë me profilin e diplomës. Kurrikula krijon mundësi që studentët të vazhdojnë ciklin e dytë të studimeve, ose të futen direkt në tregun e punës.

## SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Bordi i Akreditimit përmes VBA Nr. 51, dt. 10/07/2017, për programin e studimit *Bachelor* në “Inxhinieri Mekatronike” ka lënë rekomandimet si më poshtë:

- a. Të rekrutojë staf akademik efektiv për të përmirësuar ngarkesën e stafit aktual, si në orë mësimore, ashtu dhe në mbulimin e lëndëve sipas fushës specifike të pedagogëve.*

Institucioni ka bërë përpjekje për përmbushjen e këtij rekomandimi, duke shpallur dy herë në vit (në fillim të vitit akademik dhe përpara fillimit të semestrit të dytë) nevojat për staf të ri akademik me tituj dhe grada shkencore, sipas specifikave të çdo programi studimi [Evidencë R.1, R.2].

Gjithashtu, për t'i krijuar mundësi kualifikimi personelit akademik efektiv të departamentit, Institucioni ka aplikuar për hapjen e një programi të ri, “Doktoratë” në “Standardizimi: Integrimi evropian, transferimi i teknologjisë dhe inovacioni” pranë Departamentit të Inxhinierive, *për të cilin së fundmi është marrë përgjigje jo pozitive.*

Megjithë përpjekjet e bëra në këtë drejtim, ngarkesa e personelit akademik efektiv mbetet e lartë si në orë mësimore edhe në modulet që mbulojnë.

Rekomandimi nuk është plotësuar

- b. Të marrë masa për pasurimin e bibliotekës me literaturë të fushës së programit të studimit.*

Biblioteka e Departamentit të Inxhinierive është pasuruar me një pjesë të mirë të literaturës së detyrueshme në gjuhën shqipe, të rekomanduara në syllabuset e lëndëve [Evidencë R.3]. Institucioni angazhohet në mënyrë të vazhdueshme në përditësimin e saj [Evidencë R.4].

Rekomandimi është plotësuar plotësisht

## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Grupi i vlerësimit të jashtëm është ngritur nga ASCAL mbështetur në kërkesën e Institucionit “Albanian University” të datës, 04.12.2019, për riakreditimin e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike”.

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm janë përzgjedhur duke patur në konsideratë kompetencat profesionale në lidhje me fushën inxhinjerie ku ofrohet ky program studimi, eksperiencia e tyre në vlerësime të programeve të studimit, integriteti profesional, mungesa e konfliktit të interesit për të siguruar paanshmëri dhe objektivitet në gjykim dhe në vlerësim.

Në kuadër të hartimit të raportit, grupi ka vepruar me ndarje pune, detyrash dhe përgjegjësish të përcaktuara qartë për secilin anëtar. Grupi, në punën e tij, ka shfrytëzuar “Raportin e vlerësimit të brendshëm” të hartuar nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm, i ngritur pranë departamentit të Inxhinierive, të Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, si dhe në dokumentacionin e brendshëm të “Albanian University”, si: statutin, rregulloret dhe aktet e tjera rregullatore të tij, rregulloren e Departamentit të Inxhinierive, rregulloren e programit të studimit, etj. Grupi i vlerësuesve të jashtëm u mbështet, gjithashtu, në të dhëna të tjera që lidhen drejtëpërdrejtë me këtë program studimi, si të dhëna statistikore dhe informacione të evidentuara në sistemin AMS të ASCAL. I gjithë informacioni i deklaruar nga IAL, u verifikua gjatë vizitës vlerësuese, të kryer pranë mjediseve të “Albanian University”

Grupi i ekspertëve të jashtëm, së bashku me koordinatoren teknike të ASCAL, kreu vizitën vlerësuese pranë Universitetit Privat “Albanian University” në datat 01 dhe 02 Tetor 2020. Nga ana e Universitetit ishin marrë të gjitha masat për realizimin me sukses të vizitës, në përputhje me agjendën e vizitës dhe në respektim të masave anti Covid 19.

Koordinator teknik në këtë procedurë vlerësimi është ME. Renata Qatipi.

Më datë 16.12.2020, përmes sistemit AMS, dhe me shkresë zyrtare Nr. 80/22 Prot., Universiteti Privat “Albanian University” është njohur me Draft-Raportin e vlerësimit të jashtëm. Me datë 18.12.2020, AU përcjell nëpërmjet AMS komentin “*Ju njoftojmë se jemi dakord me përmbajtjen e Draft Raportit të Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit Bsc në "Inxhinieri Mekatronike" dhe nuk kemi komente*”.

Në këtë rast Draft Raporti kthehet ne Raport përfundimtar.

**Shënim:** Zgjatja e periudhës së vlerësimit të jashtëm, ka ardhur si pasojë e pandemisë së COVID-19.

**VLERËSIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR NË  
“INXHINIERI MEKATRONIKE”**

**I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR**

| <b>Standardi I.1</b>  |  |                              |                             |                              |
|---|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b> |  |                              |                             |                              |
| <b>Kriteret</b>   | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>  |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 1.</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.   | Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike nuk bie ndesh me interesat kombëtare.   |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.  | Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike, që ofron “Albanian University”, synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike dhe kulturore, në përputhje me interesat kombëtare.  |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.                   | Programi i studimit “Bachelor në Inxhinieri Mekatronike” është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, të shprehur në statutin e Universitetit, në planin strategjik të zhvillimit të tij dhe në planin strategjik të zhvillimit të Departamentit të Inxhinierive. Fusha e studimit të programit të studimit përputhet me fushën e veprimtarisë së departamentit të Inxhinierive të këtij institucionit. [Evidencë 1.6; 1.5; 1.4] |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 4.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.                             | Programi i studimit “Bachelor në Inxhinieri Mekatronike” është hartuar nga Departamenti i Inxhinierive, i cili është kujdesur që kurrikula të jetë në përputhje me zhvillimin ekonomik lokal e kombëtar. Për ta mundësuar departamenti është bazuar dhe në studimin e tregut të punës. [Evidencë 1.3.a,b].   |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>  | <b>Nuk përmbushet</b>  | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|   |  |                              |                             | <b>X</b>                     |

| <b>Standardi I.2</b>   |  |  |  |  |
|--|--|--|--|--|
| <b>Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</b> |  |  |  |  |
| <b>Kriteret</b>  | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>  |  |  |  |
| <b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.            | Nga verifikimi i dokumentacionit përkatës rezulton se:<br><br>Programi i studimit “Bachelor në Inxhinieri Mekatronike” është hartuar dhe ofrohet nga Departamenti i Inxhinierive dhe është në përputhje me strategjinë e zhvillimit të Institucionit si dhe të departamentit. [Evidencë 1.4; 1.5]        |  |  |  |
| <b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në   | Nga vizita në institucion si dhe nga verifikimi i dokumentacionit përkatës rezulton se drejtimet prioritare të zhvillimit akademik të institucionit janë përcaktuar në Strategjinë e Institucionit, Statutin e Universitetit si dhe në rregulloren e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike. |  |  |  |

|  |  |                              |                             |                              |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.   | [Evidencë 1.4, 1.6, 1.8], program i studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike është në përputhje me këto drejtime.   |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit. | Programi i studimit “Bacheror në Inxhinieri Mekatronike” ofrohet nga Departamenti i inxhinierive. Kjo është në përputhje me fushat studimore që ky departament mbulon. |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>   | <b>Nuk përmbushet</b>  | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|  |  |                              |                             | <b>X</b>                     |

|   |   |
|---|---|
| <b>Standardi I.3</b>  |   |
| <b>Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.</b>  |   |
| <b>Kriteret</b>   | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>   |
| <b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit. | <p>Në Rregulloren e programit të studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Mekatronike”, [Evidencë H.1], jepen objektivat e përgjithshme dhe ato specifike për formimin e studentëve, të cilat përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale. Në këtë program studimi ka një ndërthurje midis njohurive teorike, pjesës eksperimentale dhe aftësisimit praktik të studentit.</p> <p>Objektivat e përgjithshme të këtij programi studimi janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>programi ofrohet në përputhje me misionin dhe qëllimet e Institucionit dhe strategjinë për zhvillimin e tij.</li> <li>programi është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe zhvillimin ekonomik të vendit</li> <li>programi i studimit është i organizuar në module dhe i vlerësuar në kredite sipas Sistemit European të Transferimit të Krediteve (ECTS). Sasia e krediteve të grumbulluara nga studenti në një vit është 60 ECTS</li> <li>Programi i studimit synon pajisjen e studentit më njohuri bazë mbi metodat dhe parime shkencore të përgjithshme</li> </ul> <p>Objektivat specifike janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Gjatë vitit të parë u ofrohet studentëve njohuri të përgjithshme të mbështetura në lëndë të formimit bazë të karakterit shkencor</li> <li>Gjatë dy viteve të tjera akademike, studenti thellon njohuritë që përkojnë me profilin e diplomës Inxhinieri Mekatronike. Synohet për përgatitjen e ekspertëve të aftë për të operuar në këtë fushë, si dhe për mundur të integrohen në institucione me karakter specifik në fushën përkatëse.</li> <li>Njohuritë e ofruara i krijojnë mundësi studentit për të ndjekur ciklet e tjera në vazhdimësi të studimit, si dhe për të qenë të aftë të aftë të përballen me problematikat që do të ndeshin gjatë realizimit të tyre profesional.</li> <li>Në përfundim të këtij programi, studenti do të zotërojë kapacitete analitike dhe konceptet e nevojshme për të trajtuar</li> </ul> |



|  |  |                             |                              |                             |                              |  |  |  |          |
|--|--|-----------------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|--|--|--|----------|
|  | <p>problematikat e ndryshme inxhinierike në fushën e mekatronikës,</p> <p>Këto objektiva i gjejmë të trupëzuar në kurrikulën që ofrohet, organizimi i planit mësimor, ndarja e moduleve në vite, syllabuset, orët teorike dhe ato praktike, laboratorët dhe praktikat profesionale.</p>  |                             |                              |                             |                              |  |  |  |          |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p> | <p>Përpara se IAL “Albanian University” të hapte programin e studimit “Bachelor në Inxhinieri Mekatronike”, universiteti ka kryer studimin e tregut lokal të punës.</p> <p>Studimi i tregut të punës është bërë në mënyrë periodike nga IAL. Sipas dokumentacionit të ofruar rezulton se studimi i tregut të punës ka pasur qëllim jo vetëm çeljen e programit të studimit por edhe përmirësimin e kurrikulës së tij. [Evidencë 1.3]</p>   |                             |                              |                             |                              |  |  |  |          |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet, garantojnë përfitim të dijeve, aftësive, shkathëtisë e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>  | <p>Nga verifikimi rezulton se, objektivat formuese, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit “Bachelor në Inxhinieri Mekatronike” përmbushin pritshmëritë në fushën e të nxëniet si dhe garantojnë përfitim të dijeve.</p> <p>Në përfundim të këtij programi, studentët janë në gjendje të kryejnë analiza dhe kanë konceptet e nevojshme për të trajtuar problematikat e ndryshme inxhinierike në fushën e tyre të studimit. Dijet e përfuara nga ky program studimi, aftësitë dhe kompetencat që fiton studenti, u përgjigjen nevojave të tregut. [Evidencë H.1]</p> |                             |                              |                             |                              |  |  |  |          |
| <p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>  | <table border="1"> <tr> <td><b>Nuk përmbushet</b></td> <td><b>Përmbushet pjesërisht</b></td> <td><b>Përmbushet kryesisht</b></td> <td><b>Përmbushet plotësisht</b></td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td><b>X</b></td> </tr> </table>  | <b>Nuk përmbushet</b>       | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |  |  |  | <b>X</b> |
| <b>Nuk përmbushet</b>  | <b>Përmbushet pjesërisht</b>   | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |                             |                              |  |  |  |          |
|  |  |                             | <b>X</b>                     |                             |                              |  |  |  |          |

|   |   |
|---|---|
| <p><b>Standardi I.4</b></p> <p><b>Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</b></p>                          |   |
| <p><b>Kriteret</b></p>  | <p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>  |
| <p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>                     | <p>Nga verifikimi mund të themi se departamenti i inxhinierive ka përvojën e duhur në fushën e mësimdhënies [Tabela 2]. Programi mësimor “Bachelor në Inxhinieri Mekatronike” mbulohet pjesërisht nga pedagogët e departamentit dhe pjesërisht nga pedagogë të ftuar, kryesisht nga universitete të tjera të cilat kanë të njëjtin program studimi. [Tabela 6].</p> <p>Departamenti i Inxhinierive ka infrastrukturën e nevojshme për realizimin e këtij programi studimi [Tabela 16, Evidencë 1.7]</p> |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas</p> | <p>Programi i studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Mekatronike” ofrohet pranë Departamentit të Inxhinierive në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike. Departamenti i Inxhinierive ofron edhe programe të tjera studimi, të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë, me karakter inxhinierik. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe</p>   |



|   |  |                              |                             |                              |
|---|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| klasifikimit /kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.   | Ekonomike përfshin fusha akademike dhe kërkimore – shkencore në shkenca ekonomike, shkenca inxhinierike dhe Arkitekturë [Evidencë 1.8].<br>Nga verifikimi mund të themi se programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore. |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje. | Fusha e përgjithëshme dhe ajo specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike, si dhe me fushën kërkimore të njësisë bazë.  |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>  | <b>Nuk përmbushet</b>  | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|   |  |                              |                             | <b>X</b>                     |

|  |  |
|--|--|
| <b>Standardi I.5</b><br><b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.</b> |  |
| <b>Kriteret</b>  | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>  |
| <b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.            | Strukturat administrative dhe akademike të institucionit bashkëpunojnë me njëra tjetrën. Bashkëpunimi bëhet në kuadër të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe aktiviteteve ekstrakurrikulare. Detyrat e stafit janë të përcaktuara qartë në rregulloret përkatëse të departamentit, falkultetit si dhe të njësive administrative në shërbim dhe në ndihmë të realizimit të programit të studimit. Raportimi për përmbushjen e detyrave bëhet në mënyrë periodike dhe për këtë ekziston një strukture hierarkike. [Evidencë 1.2; 1.8; 2.1; 4.5; 5.2; 5.3; 6.7; 6.10] |
| <b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.   | Nga vizita në Institucion si dhe nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se: IAL ka vendosur marrëdhënie kontraktuale me biznese në dhe institucione të ndryshme. Këto marrëveshje bëhen në kuadër të zhvillimit të praktikave mësimore, për efekte të kërkimit shkencor si dhe për të ndihmuar studentët në gjetjen e një vendi pune. [Tabela 5].   |
| <b>Kriteri 3.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.  | Departamenti i inxhinierive harton në mënyrë periodike raportin analitik në lidhje me përfitimet e marrëveshjeve kontraktuale. Këto raporte janë evidentuar edhe gjatë vizitës në institucion. [Evidencë 1.9].   |
| <b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon  | Nga verifikimi rezulton se Departamenti që mbulon programin mësimor “Bachelor në Inxhinieri Mekatronike” ka vendosur marrëdhënie zyrtare   |

|   |  |                              |                             |                              |
|---|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.   | dhe bashkëpunon me kompani të ndryshme, me qëllim zhvillimin dhe mbikëqyrjen e praktikave mësimore të programit studimor.  |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 5.</b> Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtjshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit. | Nga vizita në institucion rezulton se IAL ka firmosur marrëveshje bashkëpunimi ndërinstitucional me: IER Academy, DITAK sh.p.k. dhe Soft & Solution, ku nëpërmjet tyre mbështet trajnimin profesional të mëtjshëm të studentëve. Marrëveshjet me këto kompani konsiston në reduktimin e tarifës së trajnimit të studentëve të Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike [Evidencë 1.10; 1.11] |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>  | <b>Nuk përmbushet</b>  | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|   |  |                              |                             | <b>X</b>                     |

|   |                       |                              |                             |                              |
|---|-----------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b> | <b>Nuk përmbushet</b> | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|   |                       |                              |                             | <b>X</b>                     |

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

|  |  |
|--|--|
| <b>Standardi II.1</b>  |  |
| <b>Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</b>  |  |
| <b>Kriteret</b>  | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>  |
| <b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). | Nga vizita rezulton se programi i studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Mekatronike” është i organizuar në module dhe është i vlerësuar në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Sasia e krediteve të grumbulluara gjatë një viti, nga një student që ndjek këtë program studimi është 60 kredite.<br><br>Programi ofrohet me 180 ECTS, me kohëzgjatje të normale të parashikuar 3 (tre) vite akademike.<br><br>Detyrimi përmbyllës për marrjen e diplomës shlyhet në trajtën e provimit të formimit ose për studentët me mesatare mbi 8 me mbrojtje të temës së diplomës<br><br>[Evidencë H.1] |
| <b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.  | Nga shqyrtimi i dokumentacionit të programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike, si: plani mësimor, syllabuset, Rregullorja e programit të studimit, [Evidencë H.1], si dhe gjatë takimit me personelin akademik dhe studentët, u konstatua se ky program studimi u ofron studentëve njohuri, të cilat do të jenë të nevojshme edhe për të ndjekur ciklet e tjera të njëpasnjëshme të studimit.<br><br>Programi u përgjigjet kërkesave, me të cilat do të përballen studentët gjatë realizimit të tyre profesional.  |

|  |   |                              |                             |                              |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>   | <p>Në përfundim të programit të studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Mekatronike”, studentët kanë përfituar aftësitë teorike dhe praktike të nevojshme për të trajtuar problematikat e ndryshme inxhinierike të fushës së mekatronikës. [Evidencë H.1]. Njohuritë e marra janë bashkëkohore dhe të krahasueshme me nivelin e njohurive që jepen në programe të ngjashme inxhinierike në universitete të tjera</p>  |                              |                             |                              |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p> | <p>Programi i studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Mekatronike”, ofron kompetencat e duhura në fushën e mekatronikës. Studenti pajiset me njohuritë e nevojshme për zhvillimin profesional të tij.</p>   |                              |                             |                              |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>  | <p>Plani mësimor, Syllabuset dhe rregullorja e programit të studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Mekatronike”, përmbajnë të gjithë elementët përshkrues të programit të studimit, sipas kuadrit ligjor në fuqi. Për të gjitha lëndët/modulet janë dhënë ngarkesa në kredite, format e ndryshme të mësimdhënjes, orët mësimore në auditor dhe ngarkesa jashtë auditorit, kategoria të cilës i përket, kodi i lëndës, etj.</p>                                       |                              |                             |                              |
| <p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>  | <p>Plani mësimor, i programit të studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Mekatronike”, i ka lëndët e grupuara sipas tipit të veprimtarisë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• lëndë bazë</li> <li>• lëndë karakterizuese</li> <li>• lëndë ndërdisiplinore/integruese</li> <li>• lëndë plotësuese</li> <li>• detyrime përmbyllëse</li> </ul> <p>Kreditet e grumbulluara për çdo kategori janë brenda raporteve të përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi.</p> |                              |                             |                              |
| <p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>  | <p>Nuk përmbushet</p>   | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
| <p><b>X</b></p>  |   |                              |                             |                              |

|   |  |
|---|--|
| <p><b>Standardi II.2</b><br/> <b>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.</b></p>                          |  |
| <p><b>Kriteret</b></p> <p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p> | <p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p> <p>Universiteti “Albanian University” është licensuar me VKM Nr. 197, datë 10.04.2004 “Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare jopublike “UFO Dental” dhe së fundmi i riorganizuar me Urdhër i MAS Nr. 52, datë 05.02.2016 “Për riorganizimin institucional të Universitetit Privat “Albanian University”.</p> <p>Me Vendim të Bordit të Akreditimit BA Nr. 01, datë 24.01.2020 "Per Akreditimin Institucional të Institucionit të Arsimit të Lartë, Universiteti</p> |

|   |  |          |   |            |   |               |    |      |    |
|---|--|----------|---|------------|---|---------------|----|------|----|
|   | <p>Privat “Albanian University”, universiteti ka fituar akreditim institucional me kohëzgjatje prej 3 (tre) vite. Vlefshmëria e akreditimit Institucionit është deri më 23/01/2023.</p> <p>Departamenti i Inxhinierive, është pjesë e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike ka në përbërjen e tij 3 njësi bazë, të cilat plotësojnë kriteret ligjore për të funksionuar si të tilla. Në përbërje të fakultetit janë 6 personel efektiv i kategorisë “Profesorë”.</p>  |          |   |            |   |               |    |      |    |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësive përkatëse.</p> | <p>Nga vizita në institucion rezultoi se: Përgjegjës për programin e studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Mekanike” është përgjegjësi i Departamentit me gradë shkencore “Doktor” (“PhD”) të mbrojtur në Itali.</p> <p>Departamenti ka ngritur seksionet në formën e grup-lëndëve në tre drejtimet kryesore:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• grup-lëndëve të fushës së Inxhinierisë Mekanike.</li> <li>• grup-lëndëve të fushës së Inxhinierisë Elektronike</li> <li>• grup-lëndëve të fushës së Inxhinierisë Elektrike,</li> </ul> <p>Koordinatorët e grup-lëndëve, janë specialist të fushave përkatëse, mbajnë gradën shkencore “Doktor” dhe i raportojnë përgjegjësit të departamentit në lidhje me mbarëvajtjen e grup-lëndëve.</p> <p><i>Në departamentin e Inxhinierive, përgjegjës për 8 programe studimi (5 programe studimi të ciklit të pare dhe 3 të ciklit të dytë), koordinator për të gjithë programet e studimit është përgjegjësi i departamentit. Grupi i vlerësimit rekomandoi, që për të gjitha programet e studimit të vendosen koordinatorët e tyre, të cilët do të jenë përgjegjës për ecurinë e zhvillimit të programit dhe praktikave profesionale.</i></p> |          |   |            |   |               |    |      |    |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p> <p><b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>                               | <p>Fakulteti përbëhet nga autoritetet drejtuese, organet drejtuese, njësitë bazë mësimore – shkencore (3) dhe nga administrata [Evidencë 1.8, neni 7, fq. 4]. Njësitë bazë mësimore – shkencore janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Departamenti i Inxhinierive,</li> <li>• Departamenti i Arkitekturës,</li> <li>• Departamenti i Shkencave Ekonomike.</li> </ul> <p>Për vitin aktual 2020-2021, Personeli Akademik Efektiv (PAE) në rang Fakulteti (44 pedagogë) përbëhet nga:</p> <table data-bbox="630 1646 1093 1803"> <tr> <td>Profesor</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Prof. Asoc</td> <td>3</td> </tr> <tr> <td>Doktor/Docent</td> <td>17</td> </tr> <tr> <td>Msc.</td> <td>24</td> </tr> </table> <p>Personeli ndihmës-akademik i Fakultetit përbëhet nga [Evidencë 1.8, Tabela 1]:</p> <p>Personeli ndihmës-akademik me karakter administrativ:</p> <p>a) Kryesekretari i Sekretarisë Mësimore;</p>  | Profesor | - | Prof. Asoc | 3 | Doktor/Docent | 17 | Msc. | 24 |
| Profesor  | -  |          |   |            |   |               |    |      |    |
| Prof. Asoc  | 3  |          |   |            |   |               |    |      |    |
| Doktor/Docent   | 17   |          |   |            |   |               |    |      |    |
| Msc.  | 24   |          |   |            |   |               |    |      |    |

|   |   |
|---|---|
|   | <p>b) Sekretarët e Sekretarisë Mësimore;</p> <p>Personeli ndihmës - akademik me karakter mësimor:</p> <p>a) Asistentët e Departamenteve;</p> <p>b) Laborantët;</p> <p>c) Asistent pedagogët e praktikave mësimore.</p> <p>Departamenti i Inxhinierive është pjesë e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike.</p> <p>Ky departament zhvillon veprimtarinë e tij në përputhje me aktet rregullatore të Institucionit, të cilat përditësohen në vazhdimësi në përputhje me aktet ligjore dhe nëligjore të Republikës së Shqipërisë. Departamenti i Inxhinierive ka në përbërje më shumë se 7 personel akademik efektiv dhe numri i personelit me tituj dhe gradë shkencore është më i madh se 3.[Tabela 1.3].</p> <p>Departamenti është i organizuar në tre grupe mësimore në bazë të gruplëndëve që mbulon. Personeli ndihmës akademik me karakter administrativ i fakultetit mbulon aktivitetet administrative që lidhen me aktivitetin e departamentit të Inxhinierive. Përpos tyre, në departament janë 2 personel ndihmës akademik, 1 laborant dhe 1 asistent i departamentit, të cilët mbulojnë aktivitetet në ndihmë të mësimdhënjes dhe administrimit të departamentit.</p> <p>Struktura akademike e departamentit të Inxhinierive përbëhet nga 5 programe studimi të ciklit të parë, Bachelor, dhe 3 programe studimi të ciklit të dytë, Master i Shkencave (2) dhe Master Profesional (1). Aktivizimi i personelit akademik me kohë të pjesshme dhe të ftuar krijon mundësi që të plotësohet kriteri i nivelit të kualifikimit të stafit akademik të angazhuar në mësimdhënie në ciklin e parë dhe në ciklin e dytë.</p> <p>Bazuar në verifikimin e dokumentacionit rezultojnë se njësia bazë përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin e strukturës akademike.</p> |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p> | <p>Bazuar në verifikimin e dokumentacionit rezultojnë se njësia bazë përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për kualifikimin e personelit akademik. Dokumentacioni i paraqitur dhe vizita në institucion e vërteton atë.</p> <p>Në katër vitet e fundit akademike, numri i personelit akademik efektiv në departament ka qenë mbi 7, nga të cilët me tituj dhe gradë shkencore ka qenë mbi 3. [Tabelat 2.1, 2.2, 2.3].</p> <p>Konkretisht, Departamenti i Inxhinierive, ka të dhënat si më poshtë:</p> <p><u>Në vitin akademik 2017–2018:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 23 PAE (2 Prof. Asoc., 8 Dr., 2 Dr. Proc. dhe 11 MSc).</li> <li>- 14 PAK (1 Prof.Dr., 7 Prof. Asoc., 5 Dr., dhe 1 MSc).</li> </ul> <p><u>Në vitin akademik 2018–2019:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 19 PAE (8 Dr., 3 Dr. Proc. dhe 8 MSc).</li> </ul>  |

|  |  |                              |                             |                              |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
|  | <p>- <b>16 PAK</b> (1 Prof.Dr., 7 Prof. Asoc., <b>6 Dr.</b>, 1 Dr.proc dhe <b>1 MSc</b>).</p> <p><u>Në vitin akademik 2019–2020:</u></p> <p>- <b>16 PAE</b> (7 Dr., 3 Dr. Proc. dhe 6 MSc)</p> <p>- <b>18 PAK</b> (1 Prof.Dr., 6 Prof.Asoc., 9 Dr., 1 Dr.proc., 1 Msc;</p> <p><u>Në vitin akademik 2020–2021/sem parë:</u></p> <p>- <b>16 PAE</b> (7 Dr., 2 Dr. Proc. dhe <b>7 MSc</b>)</p> <p>- <b>16 PAK</b> (1 Prof. , <b>6 Prof. Asoc.</b>, <b>6 Dr.</b>, 2 Dr. Proc. dhe <b>1 MSc</b>).</p> |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b> | <b>Nuk përmbushet</b>  | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|  |  |                              | <b>X</b>                    |                              |

|   |   |
|---|---|
| <b>Standardi II.3</b>   |   |
| <b>Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.</b>          |   |
| <b>Kriteret</b>   | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>   |
| <b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve. | <p>Programi i studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Mekatronike” ofrohet nga Departamenti i Inxhinierive pranë Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, i cili disponon të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e këtij programi studimi, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p> <p>Në departament ishin të depozituara plani mësimor i programit të studimit, syllabuset e lëndëve, Rregullorja e programit të studimit dhe Lista e personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, të aktivizuar në vite në mësimdhënje në këtë program studimi.</p>  |
| <b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.   | <p>Programi i studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Mekatronike” është i organizuar në përputhje të plotë me aktet ligjore dhe nën ligjore në Ligjit të Arsimit të Lartë. Programi është i ndarë në lëndë mësimore, module, praktike dhe detyrime përmblylëse. Çdo lëndë ndahet në aktivitete formuese si: Leksione/Seminare (ushtrime)/laboratorë/ detyra (projekte)/praktika lëndore.</p> <p>Nga shqyrtimi i planit mësimor, konstatohet se disiplinat mësimore dhe komponentët e tjerë mësimor janë të organizuara në 5 kategori: A, B, C, D dhe E. Në kategorinë A grupohen lëndë të formimit bazë, të cilat bëjnë përgatitje metodologjike dhe japin kulturë e përgjithshme. Në kategorinë B janë grupuar lënde karakterizuese, të cilat bëjnë përgatitje në fushën e mekatronikës. në kategorinë C janë futur lëndë ndërdisiplinore/ integruese me fushën e mekatronikës. lëndë të profileve dhe grup-lëndë me zgjedhje. në kategorinë D janë grupuar lëndë plotësuese, të cilat japin përgatitje për të lehtësuar hyrjen në tregun e punës. Në kategorinë E është futur detyrimi përmblylës.</p> |



|   |  |
|---|--|
|   | <p>Disiplinat mësimore të ofruara në kategoritë A, B, D, E janë lëndë të detyrueshme, ndërsa lëndët e kategorisë C janë lëndë ndërdisiplinore/integruese dhe me zgjedhje.</p> <p>Gjatë semestrit të dytë të vitit të tretë të studimeve, studenti shlyen detyrimin përmbyllës, i cili mund të jetë me mbrojtje të tezës së diplomës ose me provimin e diplomimit. në të dy rastet, studenti duhet të vlerësohet pozitivisht që të përmbyll studimet e ciklit të parë..</p>   |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>  | <p>Lëndët e programit të studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Mekatronike” janë të vlerësuara sipas Sistemit European të Transferimit të Krediteve. Programi i studimit është me 180 Kredite ECTS. Viti akademik ka 60 kredite ECTS dhe një semestër është i organizuar me 30 kredite ECTS. Shpërndarja e krediteve sipas kategorive të disiplinave nga A në E është bërë në përputhje me aktet nënligjore në fuqi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Në kategorinë A janë shpërndarë 33 ETCS ose 18.33% të programit të studimit.</li> <li>• Në kategorinë B janë shpërndarë 96 ETCS ose 53.33% të programit të studimit.</li> <li>• Në kategorinë C janë shpërndarë 23 ETCS ose 12.78% të programit të studimit.</li> <li>• Në kategorinë D janë shpërndarë 22 ECTS ose 12.22% të programit të studimit.</li> <li>• Në kategorinë E janë shpërndarë 6 ETCS ose 3.33% ECTS të programit të studimit.</li> </ul>   |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p> | <p>Nga verifikimi rezulton së të gjitha lëndët mësimore të programit të studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Mekatronike” janë të përfshirë në planin mësimor. Plani mësimor është i miratuar në senatin Akademik të AU. Në planin mësimor, [Evidencë 2.3], përfshihet i gjithë informacioni i nevojshëm në lidhje me numrin e krediteve, ndarja e krediteve sipas aktiviteteve formuese, orët mësimore në auditor dhe orët mësimore jashtë auditorit, ngarkesa javore për çdo disiplinë/modul, si dhe forma e shlyerjes përfundimtare të lëndës.</p> <p>Në syllabuset e lëndëve, [Evidencë 2.3.d], jepet informacion në lidhje me temat mësimore në leksione dhe në seminarëve, orët faktike për secilën prej temave, detyrimet lidhur me lëndën, etj. Frekuentimi / ndjekja e programit dhe mënyra e vlerësimit të dijeve përcaktohen në rregulloren e programit të studimit, [Evidencë H.1], dhe risillen sipas specifikave të lëndëve edhe në syllabuset përkatëse [Evidencë 2.3.d, Tabela 14 - 15].</p> <p>Vlerësimi i dijeve gjatë vitit bëhet si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 5% pjesëmarrja dhe aktivizimi në orët e ushtrimeve</li> <li>- 5% dorëzimi i detyrës së kursit</li> <li>- 10% pjesëmarrja dhe vlerësimi në laboratorë</li> </ul> |



|  |  |
|--|--|
|  | <ul style="list-style-type: none"> <li>- 20% provimi i ndërmjetëm/moduli</li> <li>- 60% provimi përfundimtar</li> </ul> <p>Për frekuentimin e studentëve IAL ka vendosur:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Për leksionet detyrimi është 75%</li> <li>- Për seminarët detyrimi është 75%</li> <li>- Për praktikat/laboratorët 100 %</li> </ul> <p>Kur student ka munguar në një lëndë (leksione dhe seminare) në jo më shumë se 50% të orëve, atij i jepet e drejta të hyjë në provim vetëm në sesionin e vjeshtës.</p> <p>Kur studenti ka munguar deri në 25% të orëve në laborator, atij i jepet mundësia t'i shlyejë në sesionet e shlyerjes. Nëse nuk shlyhen në sesionin e dytë, studenti duhet të ndjekë në vitin pasardhës të gjitha laboratorët.</p>  |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>  | <p>Në rregulloren e “Regjistrimeve dhe transferimeve” të “Albanian University” jepen informacionet e nevojshme për pranimin e studentëve në ciklin e parë, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve [Evidencë 2.4]. Në Rregulloren e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike jepet informacioni i nevojshme që lidhen me kriteret specifike të pranimit, transferimit të studimeve dhe ekuivalentimit të studimeve. [Evidencë H.1].</p>  |
| <p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabusët e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p> | <p>Programi i studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Mekatronike”. Ka syllabusët e detajuara për çdo lëndë. Syllabusët janë sipas një formati të miratuar. Në syllabuse janë dhënë informacionet e nevojshme lidhur me organizimin e lëndës në leksione/seminare/ushtrime/laboratore/ detyra kursi, si dhe ngarkesën përkatëse brenda dhe jashtë auditorit. Syllabusët janë ndërtuar në përputhje me elementët e përcaktuar në shtojcën Nr. 2 të VKM Nr. 41, dt. 24/01/2018.</p>  |
| <p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>  | <p>Nga vizita në institucion i vertetua se, gjatë muajit mars të vitit 2019, Departamenti i Inxhinierive rishikoi programet e studimit në <i>Bachelor, të ofruar prej tij</i>. Programi i studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Mekatronike” nuk pati ndryshime në përmbajtje, por u aplikua një rishpërndarje e krediteve dhe përditësim/unifikim i raportit ECTS/orë në auditor. [Evidencë 2.5].</p> <p><i>Ekspertët rekomanduan që për të patur një qëndrueshmëri të përmbajtjes së planit mësimor dhe të raporteve kredit/orë në auditor për lëndët inxhinjerike, raportet e përdorurat të miratohen në senatin akademik dhe të kthehen në standarde institucionale.</i></p> <p>Grupi i ekspertëve konstatoi se, në programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike është përmirësuar raporti i ndarjes së krediteve sipas grup-lëndëve të formimit ndërdisiplinor të këtij programi respektivisht në fushat elektronike, elektrike dhe mekanike, duke reflektuar rekomandimet e lëna nga vlerësimi i parë i jashtëm që i është bërë këtij programi studimi.</p> |

|                                     |  |                       |                      |                       |
|-------------------------------------|--|-----------------------|----------------------|-----------------------|
|                                     | Në fillim të çdo vitit akademik, Departamenti i Inxhinierive rishikon përmbajtjen e syllabuseve si dhe literaturën. Kjo bëhet në përputhje me legjislacionin brenda limitit 20%. [Evidencë 2.6.a,b,c]. |                       |                      |                       |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet   | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|                                     |  |                       |                      | X                     |

|  |  |
|--|--|
| <b>Standardi II.4</b>  |  |
| <b>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</b> |  |
| <b>Kriteret</b>  | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>  |
| <b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.  | Nga verifikimi rezulton se ngarkesa e programit mësimor është në përputhje me aktet ligjore. Programi është i ndërtuar nga 4500 orë studimi në total, nga të cilat 1875 janë orë studimi në auditor dhe 2625 janë orë studimi individual. Mesatarisht ngarkesa vjetore është 625 orë në auditor ndërkohë që ngarkesa javore mesatare është 21 orë në javë në auditor.[Evidencë 2.3]  |
| <b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.   | Programi i studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Mekatronike” ka për qëllim tu japë studentëve bazat teorike dhe praktike të inxhinierisë mekatronike dhe në veçanti mekatronikës auto (të automobilave) Studentët të cilët arrijnë të kenë një përgatitje të mirë gjatë periudhës trevjeçare u krijohet mundësia të integrohen në tregun e punës sidomos në atë të serviseve të automobilave. Programi krijon mundësinë që, nëse studentët dëshirojnë, të mund të thellojnë studimet, me qëllim përfitimin e kompetencave më specifike mbi tema më të profilizuara. [Evidencë 2.3. takimi me studentet, takimi me stafin akademik].   |
| <b>Kriteri 3.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.  | Nga verifikimi i programit mësimor rezulton se, lëndët dhe modulet janë shpërndarë përgjatë 3 viteve dhe 6 semestrave në mënyrë korrekte. Në këtë formë mundësohet formimi gradual i studentëve. Në vitin e parë bëhen kryesisht lëndë të formimit bazë, nëpërmjet të cilave, studentët marrin njohuritë bazë në fushat e matematikës, fizikës, kimisë, informatikës, programimit. Në vitin e dytë dhe të tretë merren njohuri të lidhura ngushtësisht me fushën e studimit. Kreditet janë shpërndarë proporcionalisht në tre fushat bazë të nderthurura të mekatronikës, fusha mekanike, fusha elektrike, fusha e elektronikës.<br><br>Ndërtimi i planit mësimor është bërë duke respektuar piramidën e dijeve, pra disiplinat paraardhëse të shërbejnë si bazë për marrjen e njohurive në disiplinën pasardhëse. Disiplinat në planin mësimor, sasia e krediteve dhe e orëve të vëna në dispozicion për secilën disiplinë, syllabuset e tyre bën të mundur që në përfundim të programit të studimit të jenë arritur objektivat formuese të këtij program studimi dhe rezultatet e të nxënit. |
| <b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit  | Nga verifikimi rezulton se programi <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Mekatronike” ngjason me programet e universiteteve të tjera, sidomos me programin e universitetit publik.   |

|   |   |
|---|---|
| <p>bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p> | <p>Plani mësimor ka në përbërjen e tij 40 disiplina/module. [Evidencë 2.3a] Shpërndarja e krediteve sipas këtyre disiplinave shtrihet në diapazonin nga 3 ECTS në 6 ECTS. Pjesa më e madhe e disiplinave janë me 4 ECTS (18 lëndë) dhe 5 ECTS (15 lëndë). Përgjithsisht kemi një shpërndarje pak a shumë të njëjtë të krediteve sipas disiplinave përbërëse të kurrikulës.</p> <p>Disiplinat janë të grupuara sipas kategorive A, B, C, D, E, duke ruajtur raportet në përqindje të përcaktuara në VKM Nr.41, date 24.01.2018. Emërtimet e lëndëve dhe syllabuset e tyre janë të ngjashme me ato të universiteteve të tjera.</p> <p>Lëndët janë të organizuara në aktivitete formuese Leksion/Ushtime (seminar)/Detyra – Projekte/laboratorë/praktika. Në secilën prej tyre ka aktivitete formuese teorike dhe praktike. Në këtë kurrikul shpërndarja e krediteve në aktivitetet formuese është si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Leksione 103 ECTS</li> <li>• Ushtime(seminare) 45 ECTS</li> <li>• Laboratorë 14 ECTS</li> <li>• Detyra/Projekte/diplomë 14 ECTS</li> <li>• Praktikë 4 ECTS</li> </ul> <p>Pra 57.2% të krediteve totale i janë alokuar përgatitjes teorike, pra leksioneve dhe 42.8% e krediteve janë të lidhura me përgatitjen praktike përfshirë këtu edhe punimi i diplomës.</p> <p>Nëse do t'i referoheshim orëve të planifikuar në auditor për këto aktivitete formuese do të kishim si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Leksione 780 Orë në auditor</li> <li>• Ushtime(seminare) 652 Orë në auditor</li> <li>• Laboratorë 335 Orë në auditor</li> <li>• Detyra/Projekte/diplomë 28 Orë në auditor</li> <li>• Praktikë 80 Orë në auditor</li> </ul> <p>Orët në auditor, gjithsej 1875, përbëjnë 41.67% të fondit total të orëve të këtij programi studimi. Orët jashtë auditorit (studim individual) përbëjnë 58.33% të ngarkesës totale.</p> <p>Raporti teori praktikë, referuar orëve në auditor do të ishte 41.6% e orëve në auditor i përkasin përgatitjes teorike (leksioneve) dhe 58.4% e orëve në auditor krediteve janë të lidhura me përgatitjen praktike përfshirë këtu edhe punimi i diplomës. Pra sasia e orëve në auditor për përgatitje praktike të studentit janë disi më të mëdha se orët e alokuar për përgatitje teorike.</p> <p>Ky program studimi e vë theksin më shumë në përgatitjen praktike të studentit. Gjykoj se në këtë disproporcion në raportet e shprehura, referuar krediteve dhe orëve në auditor, ndikon raporti 1 ECTS/orë në auditor i përdorur për këtë program studimi:</p> |
|---|---|

|   |   |
|---|---|
|   | <ul style="list-style-type: none"> <li>• 1 ECTS leksion = 7.5 orë në auditor</li> <li>• 1 ECTS Ushtrime = 15 orë në auditor</li> <li>• 1 ECTS laborator = 24 orë në auditor</li> <li>• 1 ECTS detyrë/projekt = 2 orë në auditor</li> <li>• 1 ECTS praktikë = 20 orë në auditor</li> </ul> <p><b>Grupi i ekspertëve të jashtëm sugjeron se për të forcuar përgatitjen teorike, në mënyrë që studenti të marrë njohuri të thelluara teorike për vijimin e studimeve në ciklet e tjera, është mirë të shtohet fondi i orëve në auditor për leksionet, duke respektuar gjithmonë standardin që orët në auditor të mos e kalojnë gjysmën e fondit total të orëve. Lëndët inxhinjerie kanë nevojë për shpjegime dhe interpretime të koncepteve dhe njohurive shkencore nga ana e pedagogut.</b></p> <p>Në hartimin e kurrikulës së programit të studimit “Bachelor në Inxhinieri Mekatronike, për të gjitha lëndët janë përdorur të njëjtat raporte ECTS/orë në auditor për veprimtaritë formuese të lëndës. Kjo e ka disiplinuar dhe konsoliduar kurrikulën. Por theksojmë se këto raporte nuk janë kthyer në standarde institucionale. Miratimi i një programi studimi çon në miratimin automatikisht të raporteve të ndarjes. Por departamentet janë të lire të përzgjedhin vlera brenda disa diapazoneve që përdoren në universitet [Evidencë 2.5], të cilat janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 1 ECTS leksion = 6 -12 orë në auditor</li> <li>• 1 ECTS Ushtrime = 12-18 orë në auditor</li> <li>• 1 ECTS Seminar = 6-8 orë në auditor</li> <li>• 1 ECTS laborator = 18-25 orë në auditor</li> <li>• 1 ECTS detyrë/projekt = 1-2 orë në auditor</li> <li>• 1 ECTS praktikë = 20-25 orë në auditor</li> </ul> <p><b>Sugjerojmë që për të patur konsolidim të kurrikulave inxhinjerie, të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë, raportet e kthimit të 1 krediti në orë në auditor, për të gjitha aktivitetet formuese të lëndëve, të miratohen në senatin akademik të universitetit dhe të bëhen kështu standarde institucionale. Cdo ndryshim në kurrikul, apo hartim i kurrikulave të reja do të bëhet referuar këtyre standardeve.</b></p> |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p> | <p>Nga analiza e kryer mësipër në lidhje me ndarjen e krediteve sipas aktiviteteve formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik, rezultojnë se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• fondi i orëve në auditor në raport me fondin total të orëve për programet e ciklit të parë, Bachelor, (4500 orë) është në përputhje me aktet ligjore në fuqi.</li> <li>• Fondi i orëve në auditor i alokuar për leksione përbën 41.6% të fondit të përgjithshëm të orëve në auditor.</li> </ul>   |

|  |   |
|--|---|
|  | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Fondi i orëve në auditor i alokuar për ushtrime dhe seminare përbën 34.77% të fondit të përgjithshëm të orëve në auditor</li> <li>• Fondi i orëve në auditor i alokuar për laboratorë përbën 17.87% të fondit të përgjithshëm të orëve në auditor</li> </ul> <p>Pra, raportet e ndarjes së orëve në auditor për përgatitjen praktike (ushtrime, laboratorë, praktikë, detyra) janë më të larta se për përgatitjen teorike. Do të gjykonim që fondi i orëve në auditor i alokuar për leksione të jetë jo më pak se 50% të fondit të përgjithshëm të orëve në auditor, për të gjitha lëndët inxhinjerike.</p> <p>Fondi i orëve i alokuar për formimin praktik është i përshtatshëm për arritjen e objektivave formuese dhe mundëson transferimin e studimeve dhe punësimin në përfundim të studimeve. Fondi i orëve në auditor, i alokuar për përgatitjen teorike, mundëson arritjen pjesërisht të një nga objektivave formuese, atë të vazhdimin të studimeve më të thelluara në cikline dytë, sidomos në programet e studimit “Master i Shkencave”</p> <p><b><i>Sugjerojmë që të rishikohet raporti i përdorur për alokimin e orëve në auditor për 1 ECTS leksion, pa cënuar raportet e tjera.</i></b></p> |
| <p><b>Kriteri 6.</b> Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>                          | <p>Programet e lëndëve dhe moduleve janë përditësuar krahasuar me programin fillestar. Nga vizita rezultoi se në fillim të vitit akademik programi mësimor (syllabuset e lëndëve) rishikohen dhe përmirësohen, atje ku ka nevojë të ndërhyet. [Evidencë 2.6; takimi me personelin akademik gjatë vizitës në universitet]. Literatura që përdoret për programin mësimor Bachelor në Inxhinieri Mekatronike është përmirësuar dhe është bashkëkohore. [Literatura e rekomanduar në syllabuset]</p> <p>Biblioteka e Departamentit përditësohet dhe pasurohet në vazhdimësi në funksion të azhurnimeve përkatëse të syllabuseve [Evidencë R.3, R.4].</p>  |
| <p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>                      | <p>Përmbajtja e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave në fushën e mekatronikës, referuar nivelit të 6 të kualifikimit sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimit.</p> <p>Studentët, gjatë vitit të parë, marrin njohuri të përgjithshme, të mbështetura në lëndë të formimit bazë të karakterit shkencor. Gjatë dy viteve të tjera njohuritë thellohen drejt profilit të Inxhinierisë Mekatronike. Studentët aftësohen në zgjidhjen e problemeve të thjeshta mekatronike. Në përfundim të studimeve, studenti fiton kompetencë për të menaxhuar projekte, dhënë zgjidhje dhe drejtuar punime në fushën e mekatronikës. [Evidencë H.1; 2.3, syllabuset e lendeve]</p>   |
| <p><b>Kriteri 8.</b> Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p> | <p>Ky program mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve në fushën e mekatronikës. Bazuar në teorinë e krediteve të transferueshme studentët mund të shkruhen në programe të mëtejshme studimi. Programi është në përputhje me kërkesat dhe pritshmëritë e tregut të punës sidomos të atij auto.</p>   |
| <p><b>Kriteri 9.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit</p>  | <p>Nga vizita në institucion rezultoi se programi mësimor është ndërtuar duke u konsultuar me tregun e punës. IAL ka bashkëpunim me kompani</p>   |

|   |   |                              |                             |                              |
|---|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës. | të cilat operojnë në fushën e mekatronikës sidomos të, mekatronikës auto. Si rezultat i këtij bashkëpunimi IAL ka marrë informacion në lidhje me kërkesat e tregut të punës. IAL është përpjekur të implementojë propozimet e tyre. [Evidencë 1.3; takimi me dekanin dhe përgjegjësin e departamentit], |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>  | <b>Nuk përmbushet</b>   | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|   |   |                              | X                           |                              |

| <b>Standardi II.5</b>  |   |             |           |           |           |           |           |           |           |  |     |     |     |     |     |     |     |     |      |  |   |  |   |  |   |   |   |         |   |   |  |   |  |   |   |   |        |   |   |   |   |   |   |   |   |         |  |  |  |  |   |  |   |   |     |    |  |   |   |   |  |   |   |               |           |          |           |           |           |           |           |           |               |  |           |        |           |       |           |        |                 |     |
|--|---|-------------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|--|-----|-----|-----|-----|-----|-----|-----|-----|------|--|---|--|---|--|---|---|---|---------|---|---|--|---|--|---|---|---|--------|---|---|---|---|---|---|---|---|---------|--|--|--|--|---|--|---|---|-----|----|--|---|---|---|--|---|---|---------------|-----------|----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|---------------|--|-----------|--------|-----------|-------|-----------|--------|-----------------|-----|
| <b>Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.</b> |   |             |           |           |           |           |           |           |           |  |     |     |     |     |     |     |     |     |      |  |   |  |   |  |   |   |   |         |   |   |  |   |  |   |   |   |        |   |   |   |   |   |   |   |   |         |  |  |  |  |   |  |   |   |     |    |  |   |   |   |  |   |   |               |           |          |           |           |           |           |           |           |               |  |           |        |           |       |           |        |                 |     |
| <b>Kriteret</b>  | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>   |             |           |           |           |           |           |           |           |  |     |     |     |     |     |     |     |     |      |  |   |  |   |  |   |   |   |         |   |   |  |   |  |   |   |   |        |   |   |   |   |   |   |   |   |         |  |  |  |  |   |  |   |   |     |    |  |   |   |   |  |   |   |               |           |          |           |           |           |           |           |           |               |  |           |        |           |       |           |        |                 |     |
| <b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.   | <p>Në realizimin e programit të studimit “Bachelor në Inxhinieri Mekatronikë” janë përfshirë personel akademik efektiv, personel akademik me kontratë dhe personel ndihmës akademik. Në katër vitet e fundit angazhimi i personelit akademik në mësimdhënje, në këtë program studimi dhe kualifikimi i tyre përkatësisht është si më poshtë: [Evidencat 2.7, a, b, c]:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Kualifikimi</th> <th colspan="2">2017-2018</th> <th colspan="2">2018-2019</th> <th colspan="2">2019-2020</th> <th colspan="2">2020-2021</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof</td> <td></td> <td>1</td> <td></td> <td>1</td> <td></td> <td>1</td> <td>-</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Prof As</td> <td>1</td> <td>3</td> <td></td> <td>3</td> <td></td> <td>3</td> <td>-</td> <td>3</td> </tr> <tr> <td>Dr.PhD</td> <td>7</td> <td>5</td> <td>7</td> <td>5</td> <td>6</td> <td>7</td> <td>7</td> <td>6</td> </tr> <tr> <td>Dr proc</td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> <td>2</td> <td></td> <td>1</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>10</td> <td></td> <td>7</td> <td>1</td> <td>5</td> <td></td> <td>6</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td><b>Totale</b></td> <td><b>18</b></td> <td><b>9</b></td> <td><b>14</b></td> <td><b>10</b></td> <td><b>13</b></td> <td><b>11</b></td> <td><b>14</b></td> <td><b>10</b></td> </tr> </tbody> </table> <p>Nga verifikimi i personelit akademik i përfshirë në mësimdhënje, konstatohet një qëndrueshmëri në stafin akademik. Kështu, në vitin akademik 2019-2020 rreth 57% e stafit ka qenë i angazhuar për tre vite në mësimdhënje dhe vetëm 10.7% e tyre (3 personel akademik) janë aktivizuar për herë të parë</p> <p>Nga verifikimi i të dhënave statistikore, u konstatua se për vitet e fundit mbi 70% e ngarkesës mësimore është mbajtur nga personeli akademik efektiv.</p> <p>Konkretisht [Evidenca 2.7]:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>% e ngarkesës mësimore e realizuar nga PAE</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2017-2018</td> <td>71.48%</td> </tr> <tr> <td>2018-2019</td> <td>70.3%</td> </tr> <tr> <td>2019-2020</td> <td>72.86%</td> </tr> <tr> <td>2020-2021/sem I</td> <td>75%</td> </tr> </tbody> </table> <p>Departamenti i Inxhinierive mbulon 8 programe studimi (5 Bachelor, 2 Master i Shkencave dhe 1 Master Profesional). Karakteristike është se</p> | Kualifikimi | 2017-2018 |           | 2018-2019 |           | 2019-2020 |           | 2020-2021 |  | PAE | PAK | PAE | PAK | PAE | PAK | PAE | PAK | Prof |  | 1 |  | 1 |  | 1 | - | 1 | Prof As | 1 | 3 |  | 3 |  | 3 | - | 3 | Dr.PhD | 7 | 5 | 7 | 5 | 6 | 7 | 7 | 6 | Dr proc |  |  |  |  | 2 |  | 1 | - | Msc | 10 |  | 7 | 1 | 5 |  | 6 | - | <b>Totale</b> | <b>18</b> | <b>9</b> | <b>14</b> | <b>10</b> | <b>13</b> | <b>11</b> | <b>14</b> | <b>10</b> | Viti akademik | % e ngarkesës mësimore e realizuar nga PAE | 2017-2018 | 71.48% | 2018-2019 | 70.3% | 2019-2020 | 72.86% | 2020-2021/sem I | 75% |
| Kualifikimi  | 2017-2018   |             | 2018-2019 |           | 2019-2020 |           | 2020-2021 |           |           |  |     |     |     |     |     |     |     |     |      |  |   |  |   |  |   |   |   |         |   |   |  |   |  |   |   |   |        |   |   |   |   |   |   |   |   |         |  |  |  |  |   |  |   |   |     |    |  |   |   |   |  |   |   |               |           |          |           |           |           |           |           |           |               |  |           |        |           |       |           |        |                 |     |
|  | PAE   | PAK         | PAE       | PAK       | PAE       | PAK       | PAE       | PAK       |           |  |     |     |     |     |     |     |     |     |      |  |   |  |   |  |   |   |   |         |   |   |  |   |  |   |   |   |        |   |   |   |   |   |   |   |   |         |  |  |  |  |   |  |   |   |     |    |  |   |   |   |  |   |   |               |           |          |           |           |           |           |           |           |               |  |           |        |           |       |           |        |                 |     |
| Prof   |   | 1           |           | 1         |           | 1         | -         | 1         |           |  |     |     |     |     |     |     |     |     |      |  |   |  |   |  |   |   |   |         |   |   |  |   |  |   |   |   |        |   |   |   |   |   |   |   |   |         |  |  |  |  |   |  |   |   |     |    |  |   |   |   |  |   |   |               |           |          |           |           |           |           |           |           |               |  |           |        |           |       |           |        |                 |     |
| Prof As  | 1   | 3           |           | 3         |           | 3         | -         | 3         |           |  |     |     |     |     |     |     |     |     |      |  |   |  |   |  |   |   |   |         |   |   |  |   |  |   |   |   |        |   |   |   |   |   |   |   |   |         |  |  |  |  |   |  |   |   |     |    |  |   |   |   |  |   |   |               |           |          |           |           |           |           |           |           |               |  |           |        |           |       |           |        |                 |     |
| Dr.PhD   | 7   | 5           | 7         | 5         | 6         | 7         | 7         | 6         |           |  |     |     |     |     |     |     |     |     |      |  |   |  |   |  |   |   |   |         |   |   |  |   |  |   |   |   |        |   |   |   |   |   |   |   |   |         |  |  |  |  |   |  |   |   |     |    |  |   |   |   |  |   |   |               |           |          |           |           |           |           |           |           |               |  |           |        |           |       |           |        |                 |     |
| Dr proc  |   |             |           |           | 2         |           | 1         | -         |           |  |     |     |     |     |     |     |     |     |      |  |   |  |   |  |   |   |   |         |   |   |  |   |  |   |   |   |        |   |   |   |   |   |   |   |   |         |  |  |  |  |   |  |   |   |     |    |  |   |   |   |  |   |   |               |           |          |           |           |           |           |           |           |               |  |           |        |           |       |           |        |                 |     |
| Msc  | 10  |             | 7         | 1         | 5         |           | 6         | -         |           |  |     |     |     |     |     |     |     |     |      |  |   |  |   |  |   |   |   |         |   |   |  |   |  |   |   |   |        |   |   |   |   |   |   |   |   |         |  |  |  |  |   |  |   |   |     |    |  |   |   |   |  |   |   |               |           |          |           |           |           |           |           |           |               |  |           |        |           |       |           |        |                 |     |
| <b>Totale</b>  | <b>18</b>   | <b>9</b>    | <b>14</b> | <b>10</b> | <b>13</b> | <b>11</b> | <b>14</b> | <b>10</b> |           |  |     |     |     |     |     |     |     |     |      |  |   |  |   |  |   |   |   |         |   |   |  |   |  |   |   |   |        |   |   |   |   |   |   |   |   |         |  |  |  |  |   |  |   |   |     |    |  |   |   |   |  |   |   |               |           |          |           |           |           |           |           |           |               |  |           |        |           |       |           |        |                 |     |
| Viti akademik  | % e ngarkesës mësimore e realizuar nga PAE  |             |           |           |           |           |           |           |           |  |     |     |     |     |     |     |     |     |      |  |   |  |   |  |   |   |   |         |   |   |  |   |  |   |   |   |        |   |   |   |   |   |   |   |   |         |  |  |  |  |   |  |   |   |     |    |  |   |   |   |  |   |   |               |           |          |           |           |           |           |           |           |               |  |           |        |           |       |           |        |                 |     |
| 2017-2018  | 71.48%  |             |           |           |           |           |           |           |           |  |     |     |     |     |     |     |     |     |      |  |   |  |   |  |   |   |   |         |   |   |  |   |  |   |   |   |        |   |   |   |   |   |   |   |   |         |  |  |  |  |   |  |   |   |     |    |  |   |   |   |  |   |   |               |           |          |           |           |           |           |           |           |               |  |           |        |           |       |           |        |                 |     |
| 2018-2019  | 70.3%   |             |           |           |           |           |           |           |           |  |     |     |     |     |     |     |     |     |      |  |   |  |   |  |   |   |   |         |   |   |  |   |  |   |   |   |        |   |   |   |   |   |   |   |   |         |  |  |  |  |   |  |   |   |     |    |  |   |   |   |  |   |   |               |           |          |           |           |           |           |           |           |               |  |           |        |           |       |           |        |                 |     |
| 2019-2020  | 72.86%  |             |           |           |           |           |           |           |           |  |     |     |     |     |     |     |     |     |      |  |   |  |   |  |   |   |   |         |   |   |  |   |  |   |   |   |        |   |   |   |   |   |   |   |   |         |  |  |  |  |   |  |   |   |     |    |  |   |   |   |  |   |   |               |           |          |           |           |           |           |           |           |               |  |           |        |           |       |           |        |                 |     |
| 2020-2021/sem I  | 75%   |             |           |           |           |           |           |           |           |  |     |     |     |     |     |     |     |     |      |  |   |  |   |  |   |   |   |         |   |   |  |   |  |   |   |   |        |   |   |   |   |   |   |   |   |         |  |  |  |  |   |  |   |   |     |    |  |   |   |   |  |   |   |               |           |          |           |           |           |           |           |           |               |  |           |        |           |       |           |        |                 |     |



|  |   |
|--|---|
|  | <p>programet e studimit të ciklit të pare, kanë ndërthurje me njera tjetrën në lëndët e formimit bazë dhe në disa lëndë karakterizuese. Ky fakt ndihmon në uljen e ngarkesës së pedagogut, pasi për këto lëndë, leksionet organizohen sëbashku për të gjitha programet e studimit. Pavarësisht kësaj ngarkesa në auditor e pedagogut mbetet e lartë dhe numri i lëndëve/moduleve që japin në semester dhe në vit është i lartë.</p> <p>Ngarkesa mesatare e një personel akademik efektiv, i departamentit të Inxhinierive, i realizuar në të gjitha programet e studimit që ka departamenti ose që bashkepunon, për vitin akademik 2019-2020 ka qenë rreth 553.4 ore në auditor. Ngarkesa maksimale e regjistruar për këtë vit akademik ishte 936 orë. Pedagogu me këtë ngarkesë vjetore, duhet të realizojë 6.24 orë mësimore në ditë për 30 javë mësimore që ka viti akademik.</p> <p>Numri mesatar i lëndëve/moduleve semestrare që mban një pedagog është 7.8 lëndë, me një numër maksimal lëndësh semestrare 14</p> <p><b>Kriteri në lidhje me ngarkesën mësimore dhe numrin e moduleve që mund të mbaj një pedagog nuk plotësohet.</b></p> <p>Departamenti, respekton kriterin e angazhimit në mësimdhënje të stafit me nivel kualifikimi më të lartë se ai i programit të studimit. Nga ana tjetër leksionet i zhvillojnë vetëm personeli akademik me tituj dhe gradë shkencore. Nga ana tjetër titullarë të lëndës janë personel akademik të kategorisë profesorë, të angazhuar në mësimdhënje, si PAK, për një periudhë relativisht të gjatë kohe.</p> <p><i>Grupi i ekspertëve të jashtëm rekomandon që departamenti të marrë masat për të ndryshuar këtë situatë. Universiteti Albanian University duhet të vendosë disa standarde të brendshme në lidhje me ngarkesën maksimale që mund të realizojë një personel akademik efektiv.</i></p> |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p> | <p>Nga verifikimi në institucion rezulton se programi mësimor është realizuar nga personel akademik me kualifikimin e nevojshëm. Personeli akademik me kohë të plotë ka kryesisht gradën “Doktor” dhe “MSC” ndërkohë që personeli akademik i ftuar ka kryesisht gradën shkencore “Prof” dhe “Prof As.”</p> <p>Personeli me gradë Msc është i angazhuar vetëm në zhvillimin e ushtrimeve dhe punëve laboratorike, ndërsa zhvillimi i leksioneve kryhet vetëm me personel akademik me tituj dhe gradë shkencore.</p>  |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>                                  | <p>Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se në përgjithësi personeli akademik ka nivelin e duhur të kualifikimit në fushën akademike dhe kërkimore për këtë program studimi dhe për lëndët që ata mbulonin.</p> <p><i>Grupi i vlerësimit të jashtëm gjeti vetëm një rast, ku kualifikimi në fushën akademike e personelit akademik efektiv nuk përputhej me fushën e disiplinës mësimore ku ishte angazhuar. Pedagogia ishte me diplomë Msc në arkitekturë, profili urbanist, Master dhe doktoraturë në fushën e teknologjisë së drurit, specializim për restaurim monumentesh kulture. Në programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike, ajo mbulonte</i></p>  |



|   |  |                                     |                                    |                                     |
|---|--|-------------------------------------|------------------------------------|-------------------------------------|
|   | <p>lëndët “Teknologjia e materialeve” dhe “Logjistika e industrisë mekanike”.</p> <p>Personeli akademik me kontratë ishte i angazhuar totalisht brenda fushës akademike të kualifikimit të tij.</p>  |                                     |                                    |                                     |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p> | <p>Nga vizita në institucion rezultoi se institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione të tjera të arsimit të lartë, me kompani të cilat operojnë në fushën e mekatronikës auto dhe të mekatronikës industriale. Marrëveshjet e bashkëpunimit kanë si qëllim njohjen e tregut të punës dhe realizimin e praktikave mësimore.</p> <p>Nga vizita në institucion dhe verifikimi i dokumentacionit rezultoi se praktika mësimore kryhet pranë kompanisë dhe nën drejtimin e një pedagogu. Pedagogu përgjegjës caktohet nga departamenti. Një pedagog ka në mbikëqyrje një nr prej 20 studentësh.</p> <p>Gjithashtu, në kuadër të marrëveshjeve për praktikat mësimore, parashikohet përcaktimi nga ana e institucionit pritës i një udhëheqësi të praktikës, i cili të kontrollojë dhe të informojë mbi mbarëvajtjen e saj.</p> <p>Diploma <i>Bachelor</i> mbrohet me provim formimi ose punim (tezë) diplome. Brenda një muaji nga data e fillimit të vitit akademik, Përgjegjësi i Departamentit u bën të njohur studentëve, të cilët diplomohen atë vit, programin e provimit të formimit ose të temave të diplomave, me anën e të cilave do të bëhet vlerësimi përfundimtar Studentët që kanë mesatare mbi 8 fitojnë të drejtën e zhvillimit të një punimi diplome.</p> <p>Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se, në tre vitet e fundit, 1 student ka fituar të drejtën e mbylljes së studimeve në fushën e mekatronikës me punim diplome.</p> |                                     |                                    |                                     |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>  | <p>Nga verifikimi rezulton se institucioni ka të angazhuar personel akademik ndihmës. Aktualisht për programin e studimit “Bachelor në Inxhinieri Mekatronike” është i angazhuar një laborant i cili ndjek dhe mbikëqyr mbarëvajtjen dhe zhvillimin e punëve të laboratorit.</p>   |                                     |                                    |                                     |
| <p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>   | <p><b>Nuk përmbushet</b></p>   | <p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p> | <p><b>Përmbushet kryesisht</b></p> | <p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> |
|   |  |                                     | X                                  |                                     |

|   |                              |                                     |                                    |                                     |
|---|------------------------------|-------------------------------------|------------------------------------|-------------------------------------|
| <p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b></p> | <p><b>Nuk përmbushet</b></p> | <p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p> | <p><b>Përmbushet kryesisht</b></p> | <p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> |
|   |                              |                                     | X                                  |                                     |

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

| <b>Standardi III.1</b>   |   |
|--|---|
| <b>Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>                                |   |
| <b>Kriteret</b>  | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>   |
| <p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.</p> | <p>Nga vizita në institucion u verifikua se institucioni ka hartuar një udhëzues për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative në mësimdhënie [Evidencë 3.1; 3.2; 3.3]. Në bazë të udhëzimit lejohet përdorimi i metodave kompjuterike gjatë mësimdhënies (power point, projektor, programe të ndryshme kompjuterike). Por së fundmi bazuar dhe në periudhën e vështirë të vitit akademik 2019-2020, si rezultat i pandemisë COVID19, IAL ka hartuar dhe vënë në funksionimi metodën e mësimi on-line duke përdorur programet Google classroom dhe Zoom.</p> <p>Stafi i Departamentit të Inxhinierive në bashkëpunim me NJSBC ka organizuar edhe një trajnim në nivel Universiteti për nxitjen edhe tek pedagogët e Departamenteve të tjera të përdorimit të kësaj platforme [Evidencë 3.3].</p> |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>            | <p>Në “Albanian University” janë ngritur dhe funksionojnë strukturat për monitorimin dhe vlerësimin e aftësive mësimdhënëse të personelit akademik dhe kontrollit të cilësisë, si: Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave dhe Komisioni për Kurrikulat dhe Mësimin [Evidencë 1.2]. Këto njësi në bashkëpunim të ngushtë me njësitë bazë, monitorojnë në vazhdimësi plotësimin e standardeve të cilësisë në mësimdhënie nga stafi akademik dhe ai ndihmës akademik, përmes vlerësimeve semestrale të studentëve [Evidencë 3.4] dhe raporteve semestrale të vetë pedagogëve [Evidencë 3.5].</p> <p>Vlerësimi i personelit akademik realizohet 2 (dy) herë në vit pas përfundimit të semestrit.</p>   |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>        | <p>Nga vizita në institucion rezulton se studentët janë të përfshirë në vlerësimin periodik të stafit akademik. Studentët luajnë një rol kryesor në vlerësimin e stafit akademik. Në fund të semestrit studentët plotësojnë pyetësorin e kontrollit të cilësisë, (vlerësimit të brendshëm).</p> <p>Studentët kanë të drejtë të ankimohen dhe dekanati në bashkëpunim me departamentin shqyrtojnë ankesën dhe i japin zgjidhje asaj.</p>   |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>   | <p>Nga vizita në institucion rezulton se struktura përgjegjëse bën publike dhe informon departamentin në lidhje me rezultatet e vlerësimit të brendshëm. Departamenti i analizon rezultatet në një mbledhje të veçantë [Evidencë 3.6]. Rastet specifike, apo shqetësuese diskutohen personalisht me personat e interesuar. Më pas departamenti informon pedagogët në lidhje me rezultatin e vlerësimit.</p> <p>Një analizë përmbledhëse e pyetësorëve në nivel Universiteti bëhet edhe në mbledhjen e radhës së Senatit Akademik.</p>   |

|  |   |                              |                             |                              |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies. | Nga vizita në institucion rezulton se IAL ka si parim vlerësimin dhe promovimin e praktikave të mira në mësimdhënie. Analiza e pyetësorëve, si në nivel Universiteti, ashtu edhe njësie bazë, ka për qëllim promovimin e praktikave më të mira, nxitjen e vazhdimësisë së tyre, dhe përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies. |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>   | <b>Nuk përmbushet</b>   | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|  |   |                              |                             | <b>X</b>                     |

| <b>Standardi III.2</b>  |   |
|---|---|
| <b>Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.</b>  |   |
| <b>Kriteret</b>   | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>   |
| <b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.  | Programi i studimit “Bachelor në Inxhinieri Mekatronike” bazohet në formën standarte të mësimdhënies. Transmetimi i dijeve jepet nëpërmjet, Leksioneve, Ushtrimeve/Seminarëve, Laboratorëve, Detyrave të kursit dhe praktikave profesionale.<br><br>Për programin mësimor institucioni ka organizuar, leksione të hapura dhe vizita në institucione. Vizitat janë kryher pranë qendrave industriale të cilat kanë të integruara sisteme mekatronike.[Evidencë 3.7; 3.8]   |
| <b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t’u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti. | Nga vizita në institucion është verifikuar se stafi pedagogjik i përgjigjet me seriozitet diversitetit dhe nevojave të studentëve. Pedagogët në përputhje me natyrën e programit ofrojnë metoda dhe mundësi alternative (shembuj realë, etj) në mënyrë që studenti të rrisë interesin dhe dëshirën e të nxënit. Përdorimin e sistemeve kompjuterike nuk mund të flitet pasi është diçka normale në mbarëvajtjen e mësimdhënies. Gjatë takimeve me personelin akademik dhe studentëve, u sollën shembuj të ofrimit nga ana e pedagogëve të metodave të ndryshme për ta bërë lëndën sa më të kuptueshme dhe të qartë për studentin.   |
| <b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.                       | Nga vizita në institucion rezultoi se institucioni mbështet përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible për zhvillimin e mësimdhënies me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe rritjen e rezultateve të të nxënit. Institucioni ka investuar në përmirësimin e metodave të mësimdhënies dhe kushteve të mësimdhënies.<br><br>Çdo fillim viti akademik NJSBC, organizon trajnime për stafin akademik [Evidencë 3.9], kryesisht atë të ri, të rekrutuar në kuadër të mësimdhënies. Stafi i Departamentit të Inxhinierive në bashkëpunim me NJSBC ka organizuar një trajnim në nivel Universiteti për nxitjen e përdorimit të platformës Google Classroom [Evidencë 3.3]. Institucioni gjithashtu, përmes postës elektronike ofron mundësinë e përdorimit të platformës Office 365 edhe ajo e vlefshme në kuadër të edukimit <i>online</i> . |
| <b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të   | Nga verifikimi i dokumentacionit (dosjeve të personelit akademik si dhe i formularëve të NJSCB) themi se personeli akademik është kompetent për shpjegimin e njohurive dhe koncepteve. Personeli akademik, i angazhuar pranë Departamentit të Inxhinierive, ofron një mësimdhënie   |

|   |  |                              |                             |                              |
|---|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.   | cilësore, në të cilat ndërthuren mirë njohuritë teorike të dhëna drejtëpërdrejtë gjatë leksioneve dhe seminareve me ato praktike, përmes simulimeve dhe eksperimentimeve në laboratorë [Evidencë 1.7].<br><br>Krahas tyre, stafi akademik angazhohet në nxitjen e studentëve në mësimnxënie përmes përdorimit të platformave të edukimit <i>online</i> , si Google Classroom [Evidencë 3.2], ku studentëve ju vihen në dispozicion materiale të ndryshme mësimore, teste vetëvlerësuese, detyra kursi etj.<br><br>Personeli akademik përdor metoda të ndryshme (metoda kompjuterike, metoda klasike, simulime, etj) për shpjegimin e tematikave të profilit. |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.                                     | Nga vizita në institucion rezultoj se format dhe metodat e mësimdhënies janë në vlerësim të vazhdueshëm nga vetë stafi akademik dhe departamenti që mbulon programin mësimor në fjalë. Vemendje e veçantë ju kushtohet sugjerimeve që vinë nga vetë studentët, me qëllim rritjen e nivelit të mësimnxënies dhe përmirësimin e rezultateve përfundimtare të studentëve sidomos pas rezultateve të siguruara nga NJSCB.  |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimin.   | Nga biseda me personelin akademik dhe me studentët u verifikua se gjatë orëve të seminarëve dhe leksioneve vihen në përdorim një nr. i madh shembujsh reale në mënyrë që ora mësimore të bëhet sa më tërheqëse dhe të nxitet diskutimi në lidhje me tematikën në fjalë.  |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. | Metodat e përdorura në mësimdhënie nxisin autonominë e studentit, i cili fillimisht punon nën mbikëqyrjen e pedagogut dhe më pas fillon të punojë në mënyrë graduale si i pavarur, është në gjendje të zgjidhë vete problemet e ndryshme inxhinierike në fushën e mekatronikës. Nga biseda me personelin akademik u sollën shembuj të punimeve të kryera nga studentët nën mbikëqyrjen e pedagogut, të cilat janë referuar në konferencat shkencore studentore.  |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>  | <b>Nuk përmbushet</b>  | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|   |  |                              |                             | <b>X</b>                     |

|   |   |
|---|---|
| <b>Standardi III.3</b><br><b>Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.</b> |   |
| <b>Kriteret</b>   | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>   |
| <b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.  | Nga vizita në institucion rezultoj se: Departamenti i Inxhinierive zhvillon aktivitetin në godinën në Rrugën e Kavajës. Kjo godinë është dhe në shërbim të programit të studimit “Bachelor në Inxhinieri Mekatronike” dhe të programeve të tjera me karakter inxhinierik.<br><br>Godina është në gjendje të përshtatëshme për kryerjen e procesit mësimor. Është e pastër dhe mirëmbahet rregullisht. |
| <b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e  | Godina ku zhvillohet procesi mësimor i programit të studimit “Bachelor në Inxhinieri Mekatronike” është e pajisur me salla leksioni, salla seminari dhe laboratore. Ambientet e mësipërme kanë logjistikën e nevojshme për mbarëvajtjen e procesit mësimor. Sallat e leksioneve dhe   |

|   |   |
|---|---|
| nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.   | seminarëve, kanë ndriçimin e duhur, janë të pajisur me sistemet e ngrohjes dhe ftohjes, etj.  |
| <b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.   | Nga vizita në institucion rezultoj se godina ku zhvillohet procesi mësimor i programit të studimit “Bachelor në Inxhinieri Mekatronike” është e pajisur me rrjet WIFI, sallat kanë strukturën e duhur për sistemet IT (video projektorët, kompjuterat, programet kompjuterike, etj)   |
| <b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.      | Nga verifikimi në institucion mund të themi se ciklet e leksioneve për programin e studimit “Bachelor në Inxhinieri Mekatronike” jepen në formën më poshtë:<br><br>Leksione të shkruara, në power point dhe në literaturë, formë libri. Materialet didaktike për mbarëvajtjen e procesit mësimor gjenden dhe bibliotekën e fakultetit, i cili qëndron i hapur (nga e hëna deri të shtunë) në oraret e përshtatshme për studentët.   |
| <b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor. | Në bibliotekë gjenden 112 tituj librash në fushat inxhinierike me 374 kopje [Evidencë R.3]. Biblioteka ka një numër të mjaftueshëm botimesh për drejtimin e mekatronikës. Botimet i përkasin 10 (dhjetë) viteve të fundit.<br><br>Biblioteka është në kushte optimale. Krahas botimeve dhe materialeve të shkruara gjenden dhe materiale dhe informacione të vendosura në rrjetin kompjuterik të bibliotekës.   |
| <b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.   | Në bibliotekë janë të instaluar 25 terminale të lidhura në një kompjuter qendror, të cilët vihen në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik, duke mundësuar kërkimin në internet dhe aksesimin në libraritë <i>online</i> , si: Questia, Elsevier, Getty, ERJC, Cambridge Journal, etj [Tabela 17] Informacionet e vendosura në rrjetin kompjuterik të bibliotekës shërbejnë për të krijuar librarinë on-line të universitetit. Në librarinë on-line gjendjen ciklet e leksioneve, labororet, ushtrimet e seminarëve etj. Ato mund të aksesohen lehtësisht nga studentët.<br><br>Studentëve të Departamentit të Inxhinierive përveç librarive <i>online</i> në nivel Universiteti, ju ofrohen librari <i>online</i> të fushave specifike inxhinierike që departamenti mbulon [Tabela 17]. |
| <b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.   | Nga vizita në institucion rezultoi se Departamenti i Inxhinierive në funksion të programit të studimit “Bachelor në Inxhinieri Mekatronike” ka ngritur labororet e mëposhtme. <ul style="list-style-type: none"> <li>• Labororët e Informatikës 1 – 2 (Simulimeve),</li> <li>• Laboratori i Infrastrukturës së Rrjetave,</li> <li>• Laboratori i Fizikës,</li> <li>• Laboratori i Kimisë,</li> <li>• Laboratori i Elektroteknikës,</li> <li>• Laboratori i elektronikës analoge\laboratori i elektronikës dixhitale,</li> <li>• Laboratori i matjeve elektrike dhe elektronike,</li> </ul>  |



|   |  |
|---|--|
|   | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Laboratori i automatikës dhe kontrollit (dhe Mekatronikës)</li> <li>• Laboratori i makinave elektrike.</li> </ul> <p>Në laboratorët e informatikës (simulimeve) janë të instaluar të gjitha programet (<i>software</i>) e nevojshme në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve në fushat inxhinierike. Këto <i>software</i> azhurnohen vazhdimisht, bazuar në kërkesat e pedagogëve, si dhe në funksion të versioneve të reja.</p> <p>Laboratorët janë të pajisur me aparatura dhe mjete mësimore bashkëkohore, të mjaftueshme në numër për kryerjen e orëve laboratorike. Punët laboratorike (përveç laboratorëve të informatikës) kryhen në prani të pedagogut të laboratoreve dhe laborantit, për një mbarëvajtje sa më të mirë të tyre.</p> <p>Laboratorët, nën kujdesin e stafit përgjegjës, janë të disponueshëm për studentët gjatë orëve të mësimin, për përgatitjen e detyrave të kursit, diplomave apo studimeve të tjera nga ana e tyre, si për shembull punimet për pjesëmarrjen në Konferencat Studentore.</p> <p>Në fillim të vitit akademik 2019 – 2020, Institucioni bëri një investim në Laboratorin e Informatikës 1, duke i zëvendësuar të gjithë kompjuterat ekzistues me kompjutera të rinj, me parametra, në përputhje me nevojat e <i>software</i> të programeve mësimore të ofruara dhe versionet e tyre më të fundit.</p> |
| <p><b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p> | <p>Pedagogët e angazhuar për zhvillimin e programit të studimit “Bachelor në Inxhinieri Mekatronike” kanë në përdorim platformën on-line Google-Classroom. Nëpërmjet këtyre platformave pedagogët venë në dispozicion të studentëve materialet mësimore</p> <p>Nga biseda me stafin akademik verifikuam se “Google Classroom” ka rezultuar shumë efektive dhe është bërë mjeti kryesor në mbështetje të mësimdhënies.</p>  |
| <p><b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.</p>       | <p>Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm. Në sistemin e komunikimit të brendshëm përdoret <i>email</i>-et e grupit (email i klasës) ose platformat e edukimit <i>online</i> për të komunikuar me studentët. Nëpërmjet tyre studentëve u është vënë në dispozicion materiali mësimor në format elektronik.</p>  |
| <p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>            | <p>Nga vizita në institucion rezultoi se programi i studimit “Bachelor në Inxhinieri Mekatronike” ndjek dy metoda për vlerësimin final të studentëve. Për studentët që kanë mesatare të lartë, mbi notën 8-të kanë mundësinë të zgjedhin temë diplome, ndërsa për studentët me note mesatare më të ulët për vlerësimin final përdoret metoda e provimit final.</p> <p>Nga verifikimi rezultoj se vetëm një student ka përfunduar studimet duke mbrojtur temë diplome. Në këtë rast personeli akademik i ka dhënë studentit mbështetjen e plotë në përzgjedhjen e temës, zhvillimin e saj, realizimin praktik dhe në fund departamenti ka ngritur komisionin për mbrojtjen e temës së diplomës. Punimi është prezantuar në Konferencën I<sup>re</sup> Studentore “Inovacion në Inxhinieri, Shkencë dhe Teknologji”</p>  |

|  |  |                              |                             |                              |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
|  | [Evidencë 2.11], dhe është publikuar në revistën e Universitetit “Optime” [Evidencë 2.12]. |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b> | <b>Nuk përmbushet</b>  | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|  |  |                              |                             | <b>X</b>                     |

| <b>Standardi III.4</b>   |  |
|--|--|
| <b>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</b>  |  |
| <b>Kriteret</b>  | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>  |
| <b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. | Institucioni në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies, ka ngritur strukturat përkatëse, të cilat janë: Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave [Evidencë 1.2], si dhe Komisioni për Kurrikulat dhe Mësimin [Evidencë 1.2]. Praktikant më të mira, që evidentohen gjatë analizës mësimore, u bëhen të ditur të gjitha njësitë bazë nëpërmjet një raporti që hartohet nga NJSBC.  |
| <b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.   | Programi i studimit “Bachelor në Inxhinieri Mekatronike” mbështetet nga Departamenti i Inxhinierive e cila është dhe njësi bazë përgjegjëse për zhvillimin e programit të studimit. Departamenti punon në mënyrë të vazhduar në drejtim të përmbushjes së standardeve të cilësisë në mësimdhënie, si dhe nxitjen e vetëdijes mbi rëndësinë e tyre tek stafi akademik dhe tek studentët.<br><br>Departamenti i Inxhinierive bënë analiza periodike, mbi bazën e të cilave shqyrton situatën e përmbushjes së standardeve të cilësisë së mësimdhënies, duke lënë detyra për zgjidhjen e problematikave të mundshme [Evidencë 1.1.a, b]. Çdo fillim viti, harton një strategji dhe plan masash vjetore, në të cilat parashikon edhe angazhimin për punën e vazhduar në kuadër të përmirësimit të cilësisë në mësimdhënie. [Evidencë 1.5.a, b, c]. |
| <b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.   | Nga vizita në institucion dhe verifikimi i dokumentacionit u verifikua se IAL përmes strukturave përkatëse si: Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyrrës së Zhvillimit të Kurrikulave dhe Komisionit për Kurrikulat dhe Mësimin mbështet njësinë bazë dhe stafin akademik në zhvillimin e metodave bashkëkohore në mësimdhënie.<br><br>Rezulton se, në fillim të vitit akademik 2019 – 2020, në bashkëpunim me pedagogët e Departamentit të Inxhinierive, NJSBC ka organizuar një trajnim në nivel Universiteti për përdorimin e platformës Google Classroom.  |
| <b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.   | Stafi akademik i Departamentit të Inxhinierive, për vetë formimin inxhinierik, është i angazhuar në kërkimin shkencor dhe në përdorimin e teknologjive të informacionit në mësimdhënie.<br><br>Kualifikimi i personelit akademik mundësohet nga vetë pedagogët duke u përpjekur të gjejnë metoda të reja për përmirësimin e mësimdhënies.  |



|  |  |                              |                             |                              |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.  | Nga vizita në institucion rezultoi se në fillim vitit akademik, NJSBC, organizon trajnime për stafin akademik, kryesisht me stafin e ri ose të rekrutuar. Trajnimi ka për qëllim përmirësimin e aftësive mësimdhënëse dhe mbi metodat didaktike që përdoren.   |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.                        | Nga vizita në institucion rezultoi se stafi akademik dhe ai ndihmës akademik përgjegjës për programin e studimit “Bachelor në Inxhinieri Mekatronike” ka një angazhim të plotë për mbarëvajtjen e mësimdhënies dhe përmirësimin e vazhdueshëm të saj. Sipas stafit qëllimi kryesor përkon me nxitjen e mësimnxënies tek studentët dhe përgatitjen e tyre sipas kërkesave të tregut të punës. Në këtë kuadër, stafit akademik dhe ndihmës akademik njihet me metodat më të fundit të mësimdhënies<br><br>Departamenti, gjatë mbledhjeve të përmuajshme, diskuton mbi këto metoda. |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse. | Nga vizita në institucion rezultoj se stafi akademik dhe ai ndihmës akademik përgjegjës për programin e studimit “Bachelor në Inxhinieri Mekatronike” u lejohet të testojnë metoda të reja në mësimdhënie. Në mbledhjet e departamentit bëhet një analizë mbi metodat e implementuara si dhe për rezultatet e përfuara prej tyre.  |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>   | <b>Nuk përmbushet</b>  | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|  |  |                              |                             | <b>X</b>                     |

|   |  |
|---|--|
| <b>Standardi III.5</b>  |  |
| <b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</b>  |  |
| <b>Kriteret</b>   | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>  |
| <b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.  | Kriteret e vlerësimit të studentëve janë të paraqitura në rregulloren e IAL. Megjithatë në syllabusin e lëndëve është dhënë dhe metoda e vlerësimit të studentit. Metoda e vlerësimit është publike dhe studentit është i njohur me të.  |
| <b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Nga vizita në institucion rezultoi se në fillimi të çdo viti akademik student informohet në lidhje me metodologjinë e testimit dhe vlerësimin e njohurive dhe dijeve. Vlerësimi i përgatitjes së studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të elementëve të mëposhtëm notave të: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Provimit përfundimtar 60 pikë (60% të notës përfundimtare),</li> <li>• Provimi i ndërmjetëm 20 pikë (20% të notës përfundimtare),</li> <li>• Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive në seminare, punë laboratorike, detyra/projekte kursi 20 pikë (20% të notës përfundimtare)</li> </ul> |

|   |   |                                     |                                    |   |
|---|---|-------------------------------------|------------------------------------|---|
| <p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p> | <p>Studentët njihen me format e vlerësimit që në orët e para të mesimit Kjo mundësohet nga ana e pedagogut të lëndës, gjatë njohjes së studentit mme përmbajtjen e programit të lëndës.</p> <p>Dija e studentit kontrollohet në çdo rast nëpërmjet kontaktit të vazhdueshëm të pedagogut me studentin në formën e bashkëbisedimit, nëpërmjet zhvillimit të testeve ose seancave të kontrollit të dijes.</p> |                                     |                                    |   |
| <p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>   | <p><b>Nuk përmbushet</b></p>  | <p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p> | <p><b>Përmbushet kryesisht</b></p> | <p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p> |

| <p><b>Standardi III.6</b><br/><b>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..</b></p>  |   |
|--|---|
| <p><b>Kriteret</b></p>   | <p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>  |
| <p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.</p>   | <p>Kriteret për vlerësimin e përgatitjes së studentit, jepen në rregulloren mësimore të programit të studimit [Evidencë H.1, Neni 24, fq. 17, Tabela 15]. Ky vlerësim mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm, ku nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të elementëve të mëposhtëm</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Provimi përfundimtar 60 pikë (60%),</li> <li>• Provimi i ndërmjetëm 20 pikë (20%),</li> <li>• Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive në seminare, punë laboratorike, detyra/projekte kursi 20 pikë (20%).</li> </ul> <p>Kjo mënyrë e vlerësimit u verifikua edhe gjatë vizitës në institucion. Pedagogët përgjegjës për programin mësimor të lëndës organizojnë provime të pjesëshme, pyetje gjatë orëve të leksionit ose seminarit. Vlerësimet gjatë vitit për studentët dokumentoheshin në procesverbalet e vlerësimit dhe ruheshin në sekretarinë mësimore, sëbashku me fletën e provimit.</p> |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>                                  | <p>Nga vizita në institucion rezultoi se format e testimit janë ato klasike. Kontrolli i dijes bëhet me shkrim, me gojë me detyra kursi, me projekte kursi ose me shkrim dhe me gojë, si në rastin e provimeve, ashtu dhe në testimet apo seancat e kontrollit që mund të organizohen gjatë semestrit ose gjatë vitit. Nota i komunikohet studentit në mënyrë individuale.</p> <p>Tezat e provimeve përfundimtare sekretohen me barkode, të cilat pas korigjimit nga pedagogu/ët e lëndës, c’sekretohen në Departament [Evidencë H.1].</p> <p>Në vitin akademik 2019-2020, për shkak të pandemisë COVID 19, u aplikua për herë të parë realizimi i provimeve online në platformën exam.net. Provimi u realizua në formën e quiz_it</p>  |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p> | <p>Nga vizita në institucion rezultoj se gjatë zhvillimit të provimit në sallë janë prezentë 2 pedagogë (monitorues). Pedagogët janë përgjegjës për zbatimin e rregullave të miratuara për procesin e zhvillimit të provimit dhe për çdo vendimarrje që lidhet me mbarëvajtjen e këtij procesi. Për çdo</p>   |

|  |  |
|--|--|
|  | <p>vendimarrje të kësaj natyre ata venë në dijeni menjëherë përgjegjës in e departamentit.</p> <p>Pedagogët monitorues janë lektori i lëndës dhe asistent – lektorit të lëndës ose pedagog i grupit përkatës. Në rastet kur nuk ka një të tillë, departamenti vendos një pedagog tjetër me profil të afërt me lëndën e provimit.</p>   |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>                      | <p>Në Rregulloren e programit të studimit [Evidencë H.1] dhe nga vizita në institucion rezultoi se zhvillimi i provimeve me shkrim realizohet në kushtet e anonimitetit, përmes sekretimit të provimeve. Përgjegjës për sekretimin është sekretaria mësimore. Pas korrigjimit, provimet depozitohen pranë departamentit ku bëhet ç’sekretimi tyre. Vlerësimi i bëhet i njohur studentit nëpërmjet sekretarisë mësimore të programit të studimit përkatës. Në tezën e provimit përveç vlerësimit janë dhe firmat e pedagogut apo pedagogëve që e kanë marrë pjesë në korrigjimin e saj.</p>   |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p> | <p>Po, pedagogët u japin studentëve këshilla në lidhje me lëndën mësimore. Studentët konsultohet vazhdimisht me pedagogun përgjegjës së lëndës mësimore, sidomos në vlerësimin e bërë përgjatë zhvillimit të lëndës, në laboratorë, detyra/projekte, kontrole të ndërmjetme, etj. [Evidencë H.1].</p> <p>Nëpërmjet diskutimit ata marrin këshillat e nevojshme të cilat u shërbejnë për përmirësimin e të nxëniet. Kjo u theksua edhe nga studentet gjatë takimit që u realizua me ata.</p>  |
| <p><b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>   | <p>Nga vizita në institucion si dhe nga verifikimi i listave të notave u la të kuptohej që pedagogët përpiqen të shmangin në maksimum fenomenin e kopjimit në provime. (duke realizuar teza të ndryshme dhe ndarë studentët në grupe të ndryshme, duke rritur distancën e sigurisë midis studentëve në provim, etj). Për të shmangur plagjiaturën në temat e diplomave përdoret verifikimi i materialit të punuar me materialet që ndodhen në data bazën e IAL. Ndërkohë që për materialet e kopjuara apo plagjiaturat e cilat mund të vijnë nga jashtë institucionit IAL dhe departamenti i inxhinierive nuk mund ti kontrollojë pasi akoma nuk ekziston një data bazë kombëtare.</p> <p>Këto rregulla janë të shprehura në Rregulloren e programit të studimit [Evidencë H.1].</p> |
| <p><b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>  | <p>Nga vizita në institucion si dhe nga verifikimi i provimeve të korrigjuara u verifikua se: Korrigjimi i provimit për lëndën mësimore bëhet nga pedagogu titullar. Korrigjimi mundësohet brenda 7 ditëve nga dita e përfundimit të provimit.</p> <p>Nota përfundimtare vjen si rezultat i kombinimit të vlerësimit të provimit të ndërmjetëm, provimit përfundimtar, angazhimit të studentit në seminare dhe laboratore, si dhe cilësia e detyrës së kursit të dorëzuar për lëndët, që e parashikojnë një të tillë. Pikëzimi sipas këtyre elementëve të mësipërm u bëhet i ditur studentëve nga sekretaria mësimore. Këto rregulla janë të shprehura në Rregulloren e programit të studimit [Evidencë H.1].</p>  |
| <p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të</p>  | <p>Nga vizita në institucion u verifikua se, studenti njihet me tezën e provimit pas korrigjimit dhe pas ç’sekretimit të tij. Studenti njihet me pikët totale të vlerësimit në tezë, si dhe me pikët në çdo rubrikë. Nëse studenti</p>   |

|   |  |                              |                             |                              |
|---|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| vlerësimin në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.   | konstaton se ka rubrika të pakorigjuara apo pikë të pallogaritura në vlerësimin total, ai ka të drejtë ta reklamojë provimin me anë të një kërkesë me shkrim. Studenti e depoziton kërkesën pranë sekretarisë mësimore të programit të studimit. Studenti merr përgjigje brenda 48 orëve. Këto rregulla janë të shprehura në Rregulloren e programit të studimit [Evidencë H.1].   |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet. | Nga vizita në institucion u verifikua se: Në rast se studenti depoziton në sekretarinë mësimore kërkesën për rivlerësim të tezës së provimit Dekani i Fakultetit ngre një komision <i>ad hoc</i> në përbërjen e të cilit bëjnë pjesë edhe pedagogët, të cilët kanë korigjuar tezën e provimit.<br><br>Vendimi që merret pas rivlerësimit të provimit merret bëhet i njohur studentit nëpërmjet sekretarisë mësimore.<br><br>Vendimi i bashkëlidhet proces-verbalit të provimit (fletës së provimit)<br><br>Mënyra se si vepohet përshkruhet në Rregulloren e programit të studimit [Evidencë H.1]. |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>  | <b>Nuk përmbushet</b>  | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|   |  |                              |                             | <b>X</b>                     |

|  |   |
|--|---|
| <b>Standardi III.7</b>   |   |
| <b>Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.</b>    |   |
| <b>Kriteret</b>  | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>   |
| <b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.                                    | Programi i studimit “Bachelor në Inxhinieri Mekatronike” është i strukturuar në tre vite akademike. Bazuar në strukturën e programit mësimor mund të themi se: Gjatë vitit të parë akademik, programi ka si synimin të ofrojë njohuri të përgjithshme të mbështetura në lëndë të formimit bazë të karakterit shkencor. Ndërkohë që gjatë 2 viteve të tjera akademike, programi ndryshon karakter duke pasur si qëllim vendosjen e lëndëve që përkojnë me profilin e diplomës, “Inxhinieri Mekatronike”.<br><br>Vlen për t’u theksuar se qëllimi i kësaj kurrikule është t’u ofrojë studentëve njohuri, të cilat do të jenë të nevojshme edhe për të ndjekur ciklet e tjera të njëpasnjëshme të studimit dhe në të njëjtën kohë t’u përgjigjet kërkesave me të cilat do të përballen studentët gjatë realizimit të tyre profesional. |
| <b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj). | Programi i studimit “Bachelor në Inxhinieri Mekatronike” është program i formimit inxhinierik. Programi mundëson marrjen e njohurive në fushën e teknologjisë së informacionit, por në përputhje me profilin përkatës.<br><br>Studentët e këtij programi studimor gjatë vitit të parë, zhvillojnë lëndën “Gjuhë e huaj” me 8 ECTS. Qëllimi kryesor është të thellojnë njohuritë në gjuhën angleze, por edhe pasurojnë fjalorin me terminologjinë teknike të profilit përkatës inxhinierik.<br><br>Detyrat e kursit, që zhvillohen gjatë gjithë ciklit <i>Bachelor</i> , nxisin krijimin e aftësive komunikuese dhe ndërvepruese të studentit, i cili do të jetë i aftë  |

|  |   |
|--|---|
|  | të prezantojë projektet e zhvilluara prej tij përmes raporteve dhe prezantimeve në ppt.   |
| <b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde. | Pedagogët përgjegjës për programin e studimit verifikojnë kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti në përfundim të lëndës mësimore. Kjo mundësohet nëpërmjet kontrollit të detyrave të kursit, punëve të laboratorit të cilat dorëzohen nga studentët gjatë orëve të fundit të mësimit. Në lëndë të veçanta pedagogët realizojnë dhe testime të pjesëshme.<br><br>Në fund të çdo semestri, stafi akademik harton raportin semestral, në të cilin raporton për realizimin e objektivave të mësimdhënies [Evidencë 3.5].  |
| <b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.                       | Nga vizita në institucion u verifikua se: në përfundim të çdo lënde stafi akademik përgjegjës orienton studentët drejt pikave dhe çështjeve më të rëndësishme. Këto pika mund të jenë subjekt i provimit si dhe janë elementë të rëndësishëm të cilët gjejnë përdorim në aplikime reale industriale.  |
| <b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.            | Nga vizita në institucion u verifikua se, Departamenti i Inxhinierive ka organizuar takime informuese me biznesin si dhe leksione të hapura, ku janë ftuar specialistë të inxhinierisë dhe studentët janë njohur me aplikimet më të fundit. [Evidencë 3.8].<br><br>Gjatë vitit akademik 2018-2019 u organizuan 2 takime informuese: <ul style="list-style-type: none"> <li>• me ABP (Albanian Business Partner) në lidhje me kompanitë e huaja të interesuara në programin outsourcing</li> <li>• me COD (Center for Openness and Dialogue) në lidhje me Mediat digjitale si një nga profesionet më të kërkuara nga të rinjtë.</li> </ul> dhe një leksion i hapur mbi “Getting into InfoSec: real world Overview”, organizuar me kërkues shkencor mbi Sigurinë e Aplikuar pranë grupit FireEye, Aleksandria, USA. |
| <b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.            | Bazur në kurrikulën e programit të studimit “Bachelor në Inxhinieri Mekatronike” mund të themi se ajo është hartuar në mënyrë të tillë që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikë profesionale. Temat laboratorike janë në përputhje me temat e leksioneve dhe seminarëve. Të njëjtën gjë mund të themi dhe për praktikën profesionale.  |
| <b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.                                  | Nga vizita në institucion u verifikua se në disa tema dhe detyra kursi jepet në formë të tillë që të stimulojnë punën në grup. Sipas pedagogëve përgjegjës qëllimi kryesor është të nxitin e punën në grup aftësimin në ndarjen e detyrave, ballafaqimin e rezultateve si dhe diskutimin e tyre.  |
| <b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.       | Nga vizita në institucion, në takimet me personelin akademik, studentët dhe drejtuesit i njësisë bazë e kryesore, rezultojnë se stafi akademik përgjegjës për programin e studimit “Bachelor në Inxhinieri Mekatronike” mbështet implementimin e ideve inovative, gjatë detyrave të kursit, diplomave dhe nxitjes së përmarrjes së tyre në konferenca studentore [Evidencë 2.11]. Bazuar në pajisjet laboratorike si dhe në stafin  |



|   |   |                              |                             |                              |
|---|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
|   | mësimdhënës studentët realizojnë eksperimente dhe punë inovative, nën mbikqyrjen e pedagogut, të cilat publikohen dhe në revistën e “Optime”.   |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 9.</b> Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.  | Nga vizita në institucion u verifikua se: stafi akademik përgjegjës për programin e studimit “Bachelor në Inxhinieri Mekatronike” mbështet studentët për temat inovative, për temat më interesante mundësohet dhe mbështetje financiare nga ana e institucionit. Mbështetja financiare nuk është në vlera të mëdha por është prezente. Në raste të tilla, produkti i mbetet universitetit. Kur studenti e vetëfinancon inovacionin e tij, atëherë ai është edhe zotëruesi i produktit.          |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve. | Nga vizita në institucion u verifikua se, Departamenti i Inxhinierive, përgjegjës për programin mësimor ka mundësuar mobilitetin në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar me qëllim shkëmbimin e eksperiencave me Institucionet partnere. Nëpërmjet bashkëpunimeve është mundësuar zhvillimin e vizitave informative, në institucione si: TEC- Vlorë, në laboratorin Alb-Consult-2, shkëmbimime studentore me Universitetin Teknik të Sofies në kuadër të programit CEEPUS si dhe leksione të hapura. |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>  | <b>Nuk përmbushet</b>   | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|   |   |                              |                             | <b>X</b>                     |

| <b>Standardi III.8</b>  |   |
|---|---|
| <b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</b>  |   |
| <b>Kriteret</b>   | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>   |
| <b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.   | Nga vizita në institucion u verifikua se, për zhvillimin e provimit final ose mbrojtjen e diplomës përgjegjësi i Departamentit u bën të njohur studentëve, të cilët diplomohen atë vit akademik, programin e provimit të formimit ose të temave të diplomave, me anën e të cilave do të bëhet vlerësimi përfundimtar. Njohja me to mundësohet brenda muajit të parë nga data e fillimit të vitit akademik.  |
| <b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.        | Nga vizita në institucion dhe bashkëbisedimi me studentët u verifikua se, atyre ju vihet në dispozicion baza e të dhënave me pyetjet e provimit të formimit. Pyetjet hartohen nga pedagogët e lëndëve përkatëse.<br><br>Studentëve me temë diplome ju vihet në dispozicion materiali ndihmës tema e diplomës is dhe përcaktohen datat e konsultimeve periodike.   |
| <b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. | Nga vizita në institucion si dhe nga biseda me pedagogët u verifikua se, teza e provimit përfundimtar hartohet si një përzgjedhje e pyetjeve nga baza e të dhënave të pyetjeve të provimit të formimit.<br><br>Në fondi i pyetjeve të provimit të formimit përfshihen pyetje nga lëndët mësimore të zhvilluara gjatë tre viteve të studimit, por peshën specifike e përcaktojnë modulet teknike dhe specifike të programit të studimit. Në tezën e provimit përfundimtar [Evidencë 3.14], kishte një ndarje afërsisht proporcionale të pyetjeve ndërmjet tre formimeve kryesore inxhinierike që përbënë mekatronikën: mekanike, elektrike/ automatizim, elektronike |

|  |  |
|--|--|
| <p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.</p>   | <p>Nga vizita në institucion si dhe nga biseda me pedagogët dhe studentët u verifikua se, stafi akademik i ndihmon këta të fundit gjatë periudhës së përgatitjes për provimin e formimit. Stafi akademik përgjegjës i ndihmon studentët me materialet e nevojshme mësimore, që do të shërbejnë gjatë zhvillimit të provimit.</p> <p>Ndërkohë që udhëheqësi i temës së diplomës ka detyrimin për të ndjekur studentin gjatë gjithë periudhës së punimit të temës së diplomës. Ai udhëzon studentin gjatë etapave të realizimit të projektit të diplomës.</p>  |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>  | <p>Nga vizita në institucion dhe bashkëbisedimi me studentët u verifikua se, Departamenti i Inxhinierive vë në dispozicion të studentëve laboratorët e tij, në mënyrë që ata të kryejnë punët eksperimentale për realizimin me sukses të temës së studimit.</p>  |
| <p><b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p> | <p>Nga vizita në institucion dhe bashkëbisedimi me stafin akademik dhe studentët u verifikua se, udhëheqësi i temës së diplomës ka ndjekur studentin gjatë gjithë periudhës së punimit të temës së diplomës. Ai e ka udhëzuar studentin për realizimin e projektit të diplomës, literaturën mbështetëse, shkrimin e tezës, deri në prezantimin e saj.</p> <p>Departamenti ka përcaktuar dhe afishuar grafikun e kontrollit të punimit të temës së diplomës. Kontrolli i diplomës është i detyrueshëm.</p> <p>Në rast se studenti nuk arrin të kryejë kontrollet periodike, sipas kalendarit përkatës, atij i hiqet e drejta e mbrojtjes së temës së diplomës në sesionin e parë. Studenti mund të paraqitet në sesionet pasardhëse, pasi të ketë shlyer të gjitha detyrimet për kontrolle, të përcaktuara sipas kalendarit të rradhës. Në përfundim të temës së diplomës, para dorëzimit të tij nga ana e studentit, udhëheqësi harton një vlerësim, i cili i vihet në dispozicion komisionit përfundimtar të vlerësimit, krahas kontrolleve të zhvilluara nga Departamenti mbi avancimin e punës nga ana e studentit.</p> |
| <p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>  | <p>Nga vizita në institucion si dhe nga verifikimi i dokumentacionit rezultojnë se studenti, në përfundim të provimit përfundimtar ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, është vlerësuar me notë. Nota e vlerësimit është në përputhje me sistemin e vlerësimit që përdor IAL</p>   |
| <p><b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>   | <p>Nga vizita në institucion si dhe nga verifikimi i dokumentacionit rezultojnë se studentët të cilët përfundojnë ciklin e studimeve trevjeçare pajisjen me diplomë në programin e studimit “Bachelor në Inxhinieri Mekatronike” dhe suplementin e saj. Formatit i diplomës dhe i suplementit është i miratuar nga MASR [Evidencë E.2,3,4].</p>  |
| <p><b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>   | <p>Nga vizita në institucion si dhe nga verifikimi i dokumentacionit rezultojnë se, studentëve të interesuar, me kërkesë të tyre, ju vihet në dispozicion një kopje e plotë e programit mësimor dhe syllabuset e lëndëve të zhvilluara, të firmosura nga titullari i Institucionit.</p>  |
| <p><b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti,</p>   | <p>Nga vizita në institucion si dhe nga verifikimi i dokumentacionit rezultojnë se, IAL përpunon të ruajë të dhënat e studentëve të diplomuar si dhe të ndjekë vijueshmërinë e punësimit të tyre pas diplomimit. Për disa prej</p>   |



|  |   |                              |                             |                              |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| informacione për studentin, nëse kërkohen. | studentëve të diplomuar IAL ka informacion ndërkohë që për një pjesë tjetër jo. |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b> | <b>Nuk përmbushet</b>   | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|  |   |                              |                             | <b>X</b>                     |

|   |                       |                              |                             |                              |
|---|-----------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b> | <b>Nuk përmbushet</b> | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|   |                       |                              |                             | <b>X</b>                     |

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

|   |   |
|---|---|
| <b>Standardi IV.1</b>   |   |
| <b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit</b>  |   |
| <b>Kriteret</b>   | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>   |
| <b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ. | <p>Departamenti përgjegjës për këtë program studimi mirëmban të dhëna në lidhje me stafin akademik të përfshirë në mësimdhënje, ku përfshihen lista e personelit akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme që aktivizohen çdo vit, lëndët/modulet që zhvillon secili prej tyre, ngarkesa për çdo disiplinë, ngarkesa semestrale dhe ajo totale. Aktualisht, Departamenti ka:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- PAE (16): Dr (7), Dr.proces (2), Msc (7)</li> <li>- PAK (16): Prof.Dr. (1), Prof.Asoc.Dr.(6), Dr.(6), Dr.proc.(2), Msc (1)</li> <li>- Personel ndihmës mësimor-shkencor (2) si dhe personel administrativ (9), i cili është në shërbim të të gjitha programeve të studimit që mbulon Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, në total 11 personel administrativ që mbulonin sekretarinë mësimore, detyrën e administratorit, IT, Bibliotekën.</li> </ul> <p>Përgjegjës për organizimin e programit të studimit është Departamenti i Inxhinierisë. Përgjegjësi i departamentit mban edhe detyrën e koordinatorit të programit të studimit.</p> <p>Dosje e personelit akademik efektiv dhe atij me kontrate janë të plota. Grupi i vlerësimit verifikoi disa prej tyre.</p> |
| <b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.   | Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike (FSHAE) ka një rregullore (evid.1.8 e RVB), në të cilën ndërmjet të tjerave jepet edhe procedura e rekrutimit të personelit akademik. Departamenti i Inxhinierisë paraqet nevojat për personel akademik, ku vendosen kriteret specifike për përzgjedhjen e kandidatëve. Kriteret mbeten të njëjta si për staf akademik efektiv, ashtu edhe me kontratë. Komisioni i vlerësimit përbëhet në shumicë nga antarë të departamentit. Grupi i vlerësimit verifikoi dy praktika (evid.R.1.c dhe R1, f) dhe i gjeti ato konform me   |

|  |  |                              |                             |                              |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
|  | <p>rregulloren e brendshme të FSHAE. Numri i antarëve të komisionit nga departamenti ishte më i madh se nr.i atyre të ardhur nga administrate.</p> <p>Procedurat e rekrutimit mund bëhen në fillim të çdo semestri. Për këtë ka vendim senati (evid.R2).</p>   |                              |                             |                              |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>  | <p>Departamenti ben kerkesen për rekrutim të stafit dy here në vit, para fillimit të semestrit. U verifikuan dy praktika (evid.R.1.c dhe R.1.f), në të cilat ishin specifikuar përveç kritereve të përgjithshme në bazë të kuadrit ligjor në fuqi, edhe kritere specifike, të lidhura me fushën e ekspertizës që duhet të mbulojë personeli akademik. Nga verifikimi i cv të personelit akademik, rezultoi që në përgjithësi, personeli akademik me kohë të plotë e të pjesshme aktivizoheshin në mësimdhënje brenda fushës së tyre të ekspertizës.</p> <p>Kërkesa e departamentit përcillet nga dekanati në rektorat. Zyra e Burimeve njerëzore publikon vendet vakante në faqen e internetit si dhe në mjetet e tjera të informimit publik</p> |                              |                             |                              |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p> | <p>U shqyrtuan dy praktika rekrutimi të stafit akademik për programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike. (Evid.R.1.c dhe R.1.f). Në to ishin paraqitur kritere të përgjithshme, si niveli i kualifikimit i kërkuar, fusha e arsimimit, eksperienca në punë, kualifikimi shkencor. Në kërkesën e departamentit shprehet edhe fusha për të cilën kërkohet rekrutimi i stafit, duke listuar lendët në të cilat do të angazhohet në mësimdhënje. Në dy praktikatat e shqyrtuara, personeli akademik i rekrutuar kishte ekspertizën në përputhje me kërkesat specifike të shpallura. Komisioni i vlerësimit bën renditjen e kandidatëve që plotësojnë më mire kërkesat për vendin e punës dhe ja përcjell dekanit të fakultetit.</p>      |                              |                             |                              |
| <p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>  | <b>Nuk përmbushet</b>  | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|  |  |                              |                             | <b>X</b>                     |

|   |   |
|---|---|
| <p><b>Standardi IV.2</b></p> <p><b>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive</b></p> |   |
| <b>Kriteret</b>   | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>   |
| <p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>   | <p>Personeli akademik dhe ai administrativ ka në dispozicion ambiente të dedikuara si dhe instrumenta të nevojshëm (kompjuter, lidhje internet, kancelari, etj) për kryerjen e aktiviteteve mësimore dhe administrative. Ambjentet e mësim dhënjes janë të pajisura me të gjitha mjetet e nevojshme didaktike. Ambjentet janë të hapura dhe të aksesueshme nga i gjithë personeli akademik.</p>         |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>  | <p>AU është angazhuar për sigurimin e kualifikimit të mëtejshëm të personelit akademik. Në AU mungojnë strukturat për promovimin e titujve akademik. Për këtë kandidatët kanë aplikuar në UPT. Departamenti ka aplikuar për hapje të programit të studimeve doktorale në Fushën: Standardizimi: Integrimi European, transferimi i teknologjive dhe inovacioni”, e cila nuk është miratuar nga MASR.</p> |

|   |  |                              |                             |                              |
|---|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
|   | Përpos kësaj është aplikuar për një projekt tek AKSHI. Ka marrëveshje bashkëpunimi me disa universitete në Europë, si: Universiteti Teknik i Sofjes, Universiteti i Salernos, Biruni University në Stamboll, University of Jyväskylä në Finlandë, Universita Vanvitelli, Napoli, me të cilëen bashkëpunimi është për mbështetje të studimeve doktorale. Ka patur mobilitete të stafit në kuadër të projektit Erasmus   |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor. | Zhvillimi i metodave inovative në mësimdhënje, mbështetur kryesisht në teknologjinë e Informacionit janë pjesë e kërkimit shkencor të departamentit të inxhinierisë. Tema “Teknologjia dhe mësimdhënja” ka qenë fokusi aktivitetet shkencore të departamentit (evid.4.1).<br><br>Në këtë fushë janë bërë edhe aplikime në projekte ndërkombëtare WBF dhe Erasmus+ “University pedagogy: University teaching on the spot” (evid.4.3, takimi me drejtuesit e departamentit dhe fakultetit). Në bashkëpunim me Universitetin e Salernos është bërë një trajnim me pedagogët dhe studentët, nga një Prof e Universitetit të Salernos, me temë: “Teknologjia dhe mësimdhënja. Rasti i matematikës” (evid.1.1, takim me drejtuesit e departamentit dhe fakultetit). Stafi i departamentit ka organizuar trajnim në nivel universiteti për nxitjen e përdorimit të platforms Google classroom (evid.3.3, takim me përfaqësuesin e NJSBC). |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 4.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.   | Departamenti i Inxhinierisë në FSHAE ka në përbërje të tij personel akademik me kohë të plotë (16), personel akademik me kohë të pjesshme (18), personel ndihmës akademik (1 laborant, një asistente e departamentit) dhe personel administrativ në nivel fakulteti, si sekretaria mësimore (3) biblioteka e fakultetit (1), si dhe IT.<br><br>Stafi akademik i angazhuar në mësimdhënje është me nivel kualifikimi mbi nivelin e kualifikimit të Bachelorit. Te gjithë Personeli akademik efektiv përbëhet nga Dr (7), Dr në proces (3) dhe Msc (6). Personeli akademik me kohë të pjesshme janë kryesisht me tituj akademik dhe grade shkencore.<br><br>Departamenti dëshmon se i ka burimet njerëzore të angazhuar për përmbushjen e objektivave të programit të studimit të ciklit të parë.  |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>  | <b>Nuk përmbushet</b>  | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|   |  |                              |                             | X                            |

|   |   |
|---|---|
| <b>Standardi IV.3</b>   |   |
| <b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit</b> |   |
| <b>Kriteret</b>   | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>   |
| <b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën   | Aktiviteti mësimor për programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike zhvillohet në godinën e Rrugën së Kavajës. Aty janë alokuar auditorët mësimdhënës, laboratorët dhe biblioteka. Ndërtesa është e madhe, e rikonstruktuar në të gjitha ambientet e saj, me salla leksionesh, seminaresh dhe laboratorë në funksion të fushave të |

|  |  |
|--|--|
| <p>specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>  | <p>ndryshme inxhinierike të ofruara [Evidencë 4.4, Tabela 16]. Ndriçimi është i përshtatshëm dhe hapsirat për lëvizjen e njerëzve janë më se të mjaftueshme. Kushtet higjeno-sanitare i përgjigjeshin situatës së pandemisë Covid-19</p>   |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p> | <p>Të gjitha sallat janë të pajisura me orendi të përshtatshme për zhvillimin e mësimin dhe me mjetet e nevojshme teknologjike: kompjuter, videoprojektor etj, në funksion të mbarëvajtjes së mësimdhënies. E gjithë godina mbulohet nga rrjetet interneti <i>wireless</i>, e disponueshme për të gjithë.</p>  |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>                  | <p>Në funksion të programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike, të ofruar nga Departamenti i Inxhinierive, janë ngritur 9 laboratorët mësimore, të cilët janë në shërbim të realizimit edhe të programeve të tjera të studimit që ofron departamenti në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve [Evidencë 1.7] (shih më lart).</p> <p>Laboratorët janë të pajisur me aparatura dhe mjete mësimore bashkëkohore, të mjaftueshme në numër për kryerjen e orëve laboratorike. Laboratorët, janë të disponueshëm për studentët gjatë orëve të mësimin, për përgatitjen e detyrave të kursit, diplomave apo studimeve të tjera nga ana e tyre, nën kujdesin e personelit përgjegjës për laboratorët.</p> |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>   | <p>Pranë departamentit të Inxhinierisë funksionojnë dy laboratorë të informatikës:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Laboratori i Informatikës 1</li> <li>• Laboratori i Informatikës 2 (Simulimeve),</li> </ul> <p>Në Laboratorin e Informatikës 1, kompjuterat kishin parametra të përshtatshme për të suportuar <i>software</i> në versionet e tyre më të fundit, në përputhje me programet lëndore. Gjatë vitit akademik 2019-2020 ky laborator ishte rinovuar.</p> <p>Laboratori i Informatikës 2 është pajisur me programe (simulime) të nevojshme në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve në fushat inxhinierike, të cilat janë të përditësuara.</p>                                       |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p>  | <p>Institucioni ka marrëveshje me 28 institucione në kuadër të praktikave mësimore. Për programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike praktikat mësimore zhvillohen në 10 institucione, si: (evid.Tab.5 e RVB):</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Birra Tirana</li> <li>• Fornchner</li> <li>• Dajti Ekspres</li> <li>• Euroelektra,</li> </ul>   |

|  |  |                             |                              |                             |                              |  |  |  |          |
|--|--|-----------------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|--|--|--|----------|
|  | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Autoking</li> <li>• Engineering group, etj</li> </ul> <p>Praktikat mësimore, të zhvilluara pranë këtyre institucioneve kanë patur mjedise të mjaftueshme për të akomoduar numrin jo të madh të studentëve. Të gjitha kompanitë kanë aktivitete dhe linja të automatizuara që përmbushin objektivat e praktikës mësimore të këtij programi studimi.</p> <p>Gjatë këtij viti janë shtuar marrëveshjet edhe me kompani të tjera, si: Kadiu, Mazda, Porche. Noa Holding, etj.</p> |                             |                              |                             |                              |  |  |  |          |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b> | <table border="1"> <tr> <td><b>Nuk përmbushet</b></td> <td><b>Përmbushet pjesërisht</b></td> <td><b>Përmbushet kryesisht</b></td> <td><b>Përmbushet plotësisht</b></td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td><b>X</b></td> </tr> </table>  | <b>Nuk përmbushet</b>       | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |  |  |  | <b>X</b> |
| <b>Nuk përmbushet</b>                      | <b>Përmbushet pjesërisht</b>   | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |                             |                              |  |  |  |          |
|  |  |                             | <b>X</b>                     |                             |                              |  |  |  |          |

|  |   |
|--|---|
| <b>Standardi IV.4</b>  |   |
| <b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit</b>  |   |
| <b>Kriteret</b>  | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>   |
| <b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.   | Në godinën ku zhvillohet aktiviteti mësimor i programit të studimit Bachelor ne Inxhinieri Mekatronike, funksionon një bibliotekë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit inxhinjerik. Ambjenti i dedikuar bibliotekës ofron hapësira të mjaftueshme për lexim dhe studim nga ana e studentëve. Në bibliotekë gjithashtu, janë të instaluar 25 terminale të lidhura në një kompjuter qendror, të cilët vihen në dispozicion të studentëve.   |
| <b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. | Biblioteka e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike vë në dispozicion të studentëve 112 tituj librash në fushat inxhinierike me 374 kopje. Në bibliotekë gjendet mbi 80% e literaturës në gjuhën shqipe. Këto janë tekste mësimore që rekomandohen në syllabuset e lëndëve. Këto libra gjenden në kopje të mjaftueshme dhe në edicionet e tyre më të fundit [Evidencë R.3, vizita në bibliotekë].<br><br>Literatura e ofruar si në formë <i>hardcopy</i> , në format elektronik dhe <i>online</i> mundësojnë realizimin me sukses të projekteve kërkimore-shkencore të kërkuara nga pedagogët në kuadër të mësimdhënies dhe në përgatitjen e tezës së diplomës.<br><br>Në bibliotekë kishte literature për studentët e mekatronikes. Në mungesë të një teksti bazë, materialet didaktike plotësoheshin me leksione të shkruara. |
| <b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.   | Institucioni ka siguruar aksesin e studentëve në libraritë online. Këto library aksesohen nën kujdesin e punonjësës së bibliotekës në qendrën e internetit. Libraritë <i>online</i> me drejtim kryesisht inxhinierik, të cilat e kanë të hapur aksesin janë:<br><br><a href="https://z-lib.org/">https://z-lib.org/</a><br><br><a href="http://bookboon.com">http://bookboon.com</a>  |



|  |   |                              |                             |                              |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
|  | <a href="http://www.e-booksdirectory.com/">http://www.e-booksdirectory.com/</a><br><a href="https://www.intechopen.com/">https://www.intechopen.com/</a><br><a href="http://engineeringstudymaterial.net">http://engineeringstudymaterial.net</a><br><a href="http://www.mdpi.com/">http://www.mdpi.com/</a><br><a href="http://open.ieee.org/">http://open.ieee.org/</a><br><a href="http://online-journals.org/">http://online-journals.org/</a><br><a href="https://farelettronica.it/web/">https://farelettronica.it/web/</a><br><a href="https://www.journals.elsevier.com/mechatronics/">https://www.journals.elsevier.com/mechatronics/</a><br><a href="https://www.journals.elsevier.com/information-and-software-technology/">https://www.journals.elsevier.com/information-and-software-technology/</a> |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.  | Në bibliotekë janë të instaluar 25 terminale të lidhura në një kompjuter qendror, të cilët vihen në dispozicion të studentëve, duke i mundësuar atyre kërkimin në internet dhe aksesimin e librarive <i>online</i> të këshilluara nga departamenti.   |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.  | Çdo fillim viti akademik, departamenti i Inxhinierisë bën kërkesat e tij për shtimin e librave në bibliotekë, si në tituj edhe në numër [Evidencë R.4 Shkresë Nr.976, date 08.11.2019 “Kërkesë për pasurimin e bibliotekës së departamentit të Inxhinjerive”].  |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. | Biblioteka e fakultetit është e hapur çdo ditë nga e hëna në të premte 8.00 – 16.00, dhe ditën e shtunë 8.00 – 12.00. Këto orare janë të shpallura në ambjentet e fakultetit.   |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>   | <b>Nuk përmbushet</b>   | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|  |   |                              |                             | <b>X</b>                     |

|  |   |
|--|---|
| <b>Standardi IV.5</b>  |   |
| <b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit</b> |   |
| <b>Kriteret</b>  | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>   |
| <b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.                            | <p>Sekretaria mësimore është përgjegjëse për ruajtjen, menaxhimin dhe përditësimin periodik të të dhënave të studentëve nga regjistrimi deri në diplomim. Sekretaria mësimore e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike përbëhet nga një kryesekretare, 2 sekretare për programet e studimit të ciklit të parë dhe 1 sekretare për programet e studimit të ciklit të dytë</p> <p>“Albanian University” disponon sekretarinë <i>online</i> (<a href="#">Sekretaria Online</a>). Çdo student ka llogarinë e tij, ku mund të logohet me kredencialet personale dhe të marrë informacionin personal në lidhje me të dhënat e</p> |



|  |   |
|--|---|
|  | <p>tij të perditësuar, rezultatet e arritura, lëndët të cilat duhet të frekuentojnë etj..</p> <p>Në vizitën e kryer në sekretari, u pa regjistri themeltar, regjistri i notave, disa procesverbale notash dhe procesverbali i ndërmjetëm. Regjistri themelatr ishte i plotësuar, të gjithë studentët ishin pajisur me numër matrikulimi. Nuk u gjetën parregullsi në hedhjen e rezultateve të studentëve nga procesverbalet në regjistrin e notave. Dosjet e studentëve ishin të plota. Dosjet e transferimit të studentëve ishin të plota.</p>   |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p> | <p>Informacionet që lidhen me aktivitetin e personelit akademik efektiv dhe me kontratë si dhe atij ndihmës akademik ruhen në Departament dhe në Zyrën e Burimeve Njerëzore.</p> <p>Në takimin e bërë me zyrën e burimeve njerëzore, u verifikuan 6 dosje personale të personelit akademik efektiv. U synuan dosje që nuk ishin verifikuar në vlerësimet e mëparshme (6 dosje personale).</p> <p>Dosjet ishin të plota, me të gjithë informacionin dhe të dhënat personale të personelit: CV, ID, Diplomat e kualifikimit, librezat shëndetsore, Raporti mjeko-ligjor, librezat e punës, kontrata e angazhimit, aneks kontrate. Në përgjithësi rezultoi që personeli akademik efektiv dhe me kontratë është i angazhuar në mësimdhënie brenda fushës së tyre të kompetencës. U gjet vetëm një personel akademik efektiv, kualifikimi i të cilit nuk përputhej me fushën që mbulonin disiplinat që mbulonte në programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike.</p> <p>Informacionet lidhur me partnerët e angazhuar në realizimin e programit: universitetet partnere, kompanitë ku kryhen praktikat, institucione të tjera të kërkimit, etj., ruhen në Departament dhe në zyrat përkatëse: Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes Për Studentët, Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë, Zyra e koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike etj. në funksion të fushës së bashkëpunimit.</p> |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>  | <p>Studentët përmes <a href="#">Sekretarisë Online</a> mund të aksesojnë në kohë reale të dhënat e tyre të perditësuar, rezultatet e arritura, lëndët, të cilat duhet të frekuentojnë etj.</p> <p>Informimi i personelit akademik realizohet nëpërmjet mbledhjeve, emailëve, website, platformës google classroom, office 365, të cilat në kushtet e zbatimit të rregullave të pandemisë së Covid 19 janë bërë domosdoshmeri. Departamenti i Inxhinierisë komunikimin nëpërmjet platformës google classroom kishte filluar ta aplikonte që para 2-3 vjetesh. Me fillimin e karantines, personeli akademik i departamentit morën pjesë në trajnimin e stafit akademik të fakulteteve të tjera të AU. <a href="#">(nga takimi me dekanin dhe përgjegjës të departamentit, evid.3.9)</a></p> <p>Komunikimi i pedagogëve me studentët është bërë nëpërmjet platformës google classroom <a href="#">(evid.3.3, 3.1)</a></p>  |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të</p>  | <p>Stafi akademik, ai administrativ dhe studentët disponojnë <i>email</i>-et zyrtare të Institucionit, bashkë me të cilët ofrohet paketa Office 365. Aplikacionet e kësaj pakete mundësojnë ruajtjen dhe shpërndarjen e</p>   |

|   |  |                              |                             |                              |
|---|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.   | informacionit, si dhe komunikimin interaktiv në kohë reale ndërmjet përdoruesve.<br><br>Me studentet është përdorur edhe platforma google classroom gjatë vitit akademik 2019-2020 për mësimdhënje, materiale studimore, etj. dhe exam.net për quizze dhe provime ( <a href="#">evid.3.1, 3.10, 3.12, takimi me pergjegjesen e departamentit</a> )   |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.     | Platformat e përdorura mundësojnë monitorimin në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ si dhe bën të mundur që të gjenerohen raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për drejtuesit.<br><br>Sistemi i menaxhimit siguron monitorimin e mësimdhënjes dhe të realizimit të aktiviteteve të tjera formuese edhe gjatë zhvillimit të mësimin në auditor apo gjatë procesit të kryerjes së praktikave dhe punimeve të diplomave.<br><br>Personeli akademik harton nje raport semestral në lidhje ecurinë dhe problematikat e dala gjatë zhvillimit te mësimin |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe. | Në faqen web të Institucionit ( <a href="#">Albanian University</a> ) jepen informacione lidhur me programet e studimit të ofruara nga <a href="#">Departamenti i Inxhinierive</a> , aktivitetet e ndryshme të zhvilluara nga Institucioni, të cilat janë në azhornim të vazhdueshëm etj.. Faqja web është e ndërtuar në dy gjuhë shqip dhe anglisht.  |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>  | <b>Nuk përmbushet</b>  | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|   |  |                              |                             | <b>X</b>                     |

|  |   |
|--|---|
| <b>Standardi IV.6</b><br><b>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</b> |   |
| <b>Kriteret</b>  | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>   |
| <b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.       | “Albanian University”, si pjesë e Shoqërisë UFO shpk, i akordohet një buxhet vjetor në përputhje me nevojat, bazuar në programin financiar afatmesëm tre vjeçar.<br><br>Buxheti vjetor dhe ai afatmesëm tre vjeçar, hartohet në përputhje me Standardet Kombëtare të hartimit dhe raportimit financiar, rregullave të përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi si dhe në aktet normative të “Albanian University”, dhe strategjinë e zhvillimit institucional të tij.<br><br>Procesi i hartimit të programi financiar fillon në muajin Shtator dhe miratohet në organet përkatëse brenda muajit Dhjetor të vitit paraardhës financiar.<br><br>Para fillimit të vitit të ri akademik, Bordi i Administrimit vendos kriteret mbi të cilat do hartohet projektbuxheti vjetor dhe rregullat për mënyrën e shpërndarjes së të ardhurave që siguron institucioni nga |

|   |   |
|---|---|
|   | <p>ushtrimi i veprimtarive të tij dhe ja përcjell organeve drejtuese akademike dhe administrative.</p> <p>Bazuar në këto kritere, Administratori i Përgjithshëm i “Albanian University”, i cili është edhe anëtar i Rektoratit, në bashkëpunim me zyrën e financës dhe administratorët e njësive kryesore, mbështetur në nevojat e paraqitura nga njësitë bazë dhe kryesore, harton projektbuxhetin vjetor dhe atë afat mesëm tre vjeçar.</p> <p>Buxheti vjetor dhe ai afatmesëm tre vjeçar, pasi diskutohet në Rektorat, kalon në Senatin Akademik. Senati e miraton paraprakisht dhe ia përcjellë për miratim përfundimtar Bordit të Administrimit.</p> <p>Institucioni ka siguruar në vazhdimësi mbështetje financiare për mbarëvajtjen e programit të studimit, nepermjet rinovimit të laboratorëve, pasurimit të bibliotekës, mbështetjes në mobilitete, etj.</p>  |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p> | <p>Struktura e programit financiar bëhet duke i ndarë të ardhurat sipas burimeve të krijimit të tyre dhe shpenzimet sipas drejtimeve, në të cilin ato do të përdoren.</p> <p>Burimet financiare të institucionit hartohen duke mbajtur në konsideratë nevojat e zhvillimit normal të veprimtarive mësimore dhe shkencore të tij, duke ndjekur një politikë transparente dhe gjithëpërfshirëse të shpërndarjes së tyre.</p> <p>Për sa i përket raporteve që zënë shpenzimet për veprimtarinë mësimore dhe shkencore, ato janë kryesisht të veprimtarisë mësimore të “Albanian University” dhe përfshijnë pagat dhe kontributet, shpenzime për kërkimin shkencor dhe fondin e ekselencës, shpenzime të përgjithshme operative etj..</p> <p>Të gjitha zërat e mësipërme bëhen bazuar në nevojat e njësive bazë dhe kryesore, përfshirë gjithashtu planin e investimit dhe mbikëqyr zbatimin e tyre, ku përfshihen financimet për burimet njerëzore në shërbim të programit të studimit, kërkesat për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të kërkuara, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse, si p.sh. investimet në laboratorin e informatikës, shpenzime për pasurimin e literaturës dhe bibliotekave online dhe të gjithë zërave të tjerë të njësisë bazë.</p> |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>   | <p>Në “Albanian University” është ngritur dhe funksionon si njësi administrative, Zyra e Auditit të Brendshëm. Zyra e Auditit të Brendshëm, si pjesë integrale e kontrollit të brendshëm dhe njësi e specializuar e saj, ka për mision kontrollin e proceduarve dhe rregullave të vendosura në rregulloren e funksionimit të Zyrës së Financës dhe Auditit të Brendshëm.</p> <p>Institucioni kryen edhe audit të përvitshëm për situatën financiare nga një kontabël i miratuar dhe i regjistruar, e cila bëhet mbi bilancin e çdo viti kalendarik, raportet e të cilëve ndërtohen sipas standardeve përkatëse.</p>   |

|  |  |                                     |                                    |                                     |
|--|--|-------------------------------------|------------------------------------|-------------------------------------|
|  | <p>Raporti i auditit përmban një pasqyrë të hollësishme referuar bilancit për të ardhurat dhe shpenzimet.</p> <p>Raportet e auditit të brendshëm dhe të jashtëm analizojnë eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve dhe përdorimin e tyre për të bërë të mundur rritjen e cilësisë së studimeve për të gjitha ciklet. Ato raportohen në mënyrë periodike pranë Bordit të Administrimit.</p>  |                                     |                                    |                                     |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p> | <p>Institucioni ka të dokumentuara raportet financiare për të tri vitet e fundit, procedurat e të cilave fillojnë të kryen gjatë periudhës Mars – Maj. Rektorati përgatit raportin financiar të realizuar, mbështetur në planifikimet e kryera në programin financiar. Ky raport miratohet nga Bordi i Administrimit. Në përfundim të kësaj faze realizohet edhe një analizë që planifikon ndërhyrjet e nevojshme në të ardhmen për mbarëvajtjen e programeve të studimit.</p> |                                     |                                    |                                     |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p> | <p>Situata financiare dhe bankare dëshmon se “Albanian University” ka qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të këtij programi studimi dhe ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësim të mëtejshëm dhe gjenerim të të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>   |                                     |                                    |                                     |
| <p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>  | <p><b>Nuk përmbushet</b></p>   | <p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p> | <p><b>Përmbushet kryesisht</b></p> | <p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> |
|  |  |                                     |                                    | <p><b>X</b></p>                     |

|   |                              |                                     |                                    |                                     |
|---|------------------------------|-------------------------------------|------------------------------------|-------------------------------------|
| <p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b></p> | <p><b>Nuk përmbushet</b></p> | <p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p> | <p><b>Përmbushet kryesisht</b></p> | <p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> |
|   |                              |                                     |                                    | <p><b>X</b></p>                     |

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

|  |   |
|--|---|
| <p><b>Standardi V.1</b><br/> <b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit</b></p> |   |
| <p><b>Kriteret</b></p>   | <p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>  |
| <p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>                                     | <p>Institucioni, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore, zbaton politika dhe procedura, të cilat garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta, për të gjithë kandidatët për studentë, duke mundur ndjekjen korrekte të kandidatit që nga momenti i aplikimit, më pas regjistrimit dhe deri në përmbylljen e detyrimeve akademike dhe diplomimin e tij. Këto politika dhe procedura shprehen në planin strategjik të universitetit, Statutin e</p> |

|   |  |
|---|--|
|   | Universitetit, Rregulloren e Universitetit dhe në rregulloren e fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike. (evid.1.4, 1.6, 1.2, 1.8)  |
| <b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.   | Në Planin strategjik të zhvillimit, Statut, Rregulloren e AU, Rregulloren e FSHAE shprehet qartë garantimi i barazisë dhe i të drejtave të njëjta për të gjithë kandidatët dhe studentët e universitetit, mbështetja e vazhdueshme e tyre nëpërmjet programit të ekselencës, bursa për familje ne nevojë, komuniteti rom e egjiptian, fëmijët e policëve të vrarë, etj. Institucioni ka ngritur struktura si Zyra e Koordinimit dhe mbështetjes për studentët dhe Zyra e karrierës dhe Alumnit.  |
| <b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. | Në rregulloren mësimore të programit të studimit jepen informacione mbi kriteret dhe procedurat e pranimit të studentëve [Evidencë H.1], vlerësimit të dijeve [Evidencë H.] dhe diplomimit [Evidencë H.1]. Në rregulloren e Regjistrimeve dhe Transferimeve jepen informacione të detajuara për njohjen e plotë ose të pjesshme të studimeve të mëparshme [Evidencë 2.4]. Të gjitha këto informacione vihen në dispozicion të studentëve nga strukturat përkatëse, të cilat janë të disponueshme edhe për sqarime të mëtejshme. Në takimin me studentët u theksua ndihma, mbështetja dhe sqarimet që marrin për çdo problem që hasin   |
| <b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.   | Kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve në programet e studimit <i>Bachelor</i> të ofruara nga Departamenti i Inxhinierive janë: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mesatarja e përgjithshme 70%,</li> <li>• Mesatarja e gruplëndëve 30%, <ul style="list-style-type: none"> <li>- Informatikë 10%,</li> <li>- Matematikë 10%,</li> <li>- Fizikë 10%.</li> </ul> </li> </ul> <p>Këto kriteret i dërgohen ministrisë përgjegjëse për arsim në periudhën e kërkuar prej saj. Kriteret bëhen publike në portalin e maturës shtetërore për të gjithë kandidatët.</p>   |
| <b>Kriteri 5.</b> Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.   | Aplikimi kryhet nga kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë, dhe janë të pajisur me [Evidencë H.1, Neni 10, pika 2, fq. 9]: <ol style="list-style-type: none"> <li>a. dokumentacionin ligjor të përfundimit të këtij niveli arsimor;</li> <li>b. nuk rezultojnë të regjistruar në një program tjetër studimi, në IAL-të publike ose jopublike;</li> <li>c. plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave;</li> <li>d. plotësojnë kriteret e përcaktuara nga AU për programin e studimit për të cilin aplikojnë.</li> </ol> <p>Në programet e ciklit të parë mund të regjistrohen edhe studentë të huaj në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin [Evidencë 2.4, Neni 13, fq. 6].</p> |
| <b>Kriteri 6.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon   | Institucioni fillon informimin e maturantëve gjatë ditëve të informimit të organizuara nga MASR, dhe më pas, në vazhdim, për kandidatët e  |



|   |   |                              |                             |                              |
|---|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit. | interesuar për programet e studimit që ofron, me informacione më të detajuara mbi përmbajtjen e programeve të studimit dhe kriteret për pranimin në to. Në takimin me përfaqësuesit e Zyrës së Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët dhe Zyrës së Karrierës dhe Alumnit u theksua që ndiqen politika për tërheqjen e kandidatëve duke vajtur në shkolla në qytete të ndryshme, duke organizuar panairin e shkollave, ditët e informimit të kandidatëve si dhe panairin e punës.<br><br>Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike publikohen në portalin U-Albania si dhe në website e universitetit |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>  | <b>Nuk përmbushet</b>   | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|   |   |                              |                             | <b>X</b>                     |

| <b>Standardi V.2</b>  |  |
|---|--|
| <b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program</b> |  |
| <b>Kriteret</b>   | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>  |
| <b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.  | <p>Institucioni që në regjistrim nje studentët me përmbajtjen e programit të studimit dhe rregulloren përkatëse, me vëmendje të veçantë në procedurat e përparimit të tyre akademik dhe kalimit nga një vit në tjetrin <b>[Evidencë H.1, Neni 25, fq. 18 - 19]:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Studenti, i cili në përfundim të vitit akademik nuk merr 50% të lëndëve (së bashku me sesionin e vjeshtës), nuk kalon në vitin akademik pasardhës, por mbetet në stazh.</li> <li>Studenti detyrohet të frekuentojë lëndët e të rifutet në sesionet përkatëse të provimit.</li> <li>Studenti fiton të drejtën e mbrojtjes së diplomës (ose provim formimi), nëse ka shlyer të gjitha detyrimet e prapambetura të programit mësimor.</li> </ol> <p>Në takimin me përfaqësuesit e Zyrës së Koordinimit dhe Mbështetjes së Studentëve dhe të Zyrës së Karrierës e Alumnit u theksua organizimi i ditëve të informimit, ku studentët marrin informacion në lidhje me rregulloren e programit të studimit dhe kriteret për të kaluar në vitin pasardhës</p> |
| <b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.  | <p>Në AU është ngritur dhe funksionon një njësi, Zyra e Transferimeve dhe Ekuivalentimeve të Studimeve, <b>[Evidencë 2.4, Neni 3, fq. 2]</b> përgjegjëse për transferimin e studimeve. Ajo ka një rol pritës dhe administrues të dokumentacionit. Kjo zyrë bashkëpunon ngushtë me Departamentin, dhe informon studentët e interesuar me procedurat përkatëse për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve. Institucioni ka një Rregullore për Regjistrimet dhe Transferimin e Studimeve, ku jepen kërkesat për dokumentacion dhe procedurat për transferimin e studimeve.</p> <p>Në takimin me sekretarinë mësimore u verifikua procedura e transferimit, në dosjen e një student të transferuar. Dosja përmbante të gjithë</p>  |



|   |   |                              |                             |                              |
|---|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
|   | dokumentacionin e detyrueshëm të parqitur nga kandidati, si dhe vendimet e komisionit Ad-hoc për njohjen e krediteve. Komisioni përbëhet nga pedagogë të departamentit.   |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.   | Gjatë javës së parë të vitit akademik, Institucioni organizon ditët orientuese, gjatë të cilave, stafi akademik, stafi administrativ dhe Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët (ZKMS) janë në dispozicion të studentëve, duke i informuar mbi procedurat e ndryshme që ndjekin mbarëvajtjen e studimeve të tyre, të tilla si kalendari akademik, orari mësimor, frekuentimi, organizimi i klasave, grupeve, ambjentet mësimore etj.. Gjatë orëve të para të mësimin, gjithashtu, pedagogët njohin studentët me përmbajtjen e syllabusit të lëndës, në të cilën përfshihen edhe format e vlerësimit konkret për secilën lëndë [Evid. H.1, Evid. 2.3.d, takim me drejtuesit e fakultetit dhe departamentit]. |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.  | Brenda një muaji nga data e fillimit të vitit akademik, Përgjegjësi i Departamentit u bën të njohur studentëve, të cilët diplomohen atë vit, programin e provimit të formimit [Evid. 3.12.a,b] ose të temave të diplomave [Evid. 3.13.a,b], me anën e të cilave do të bëhet vlerësimi përfundimtar.<br><br>Diploma “Bachelor” mund të fitohet duke dhënë një provim të përgjithshëm formimi, i cili është alternativë me mbrojtjen e një punimi diplome për studentët që kanë mesatare mbi 8 [Evid. H.1, Neni 29, fq. 20].  |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit. | Institucioni fillon informimin e maturantëve gjatë ditëve të informimit të organizuara nga MASR, dhe më pas në vazhdim për kandidatët e interesuar për programet e studimit që ofron me informacione më të detajuara mbi përmbajtjen e programeve të studimit dhe kriteret për pranimin në to.  |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>  | <b>Nuk përmbushet</b>   | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|   |   |                              |                             | <b>X</b>                     |

|  |  |
|--|--|
| <b>Standardi V.3</b>   |  |
| <b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit</b> |  |
| <b>Kriteret</b>  | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>  |
| <b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.   | Gjatë javës së parë të vitit akademik, Institucioni organizon ditët orientuese, gjatë të cilave stafi akademik, stafi administrativ dhe Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët (ZKMS) janë në dispozicion të studentëve, duke i informuar mbi procedurat e ndryshme që ndjekin mbarëvajtjen e studimeve të tyre, të tilla si kalendari akademik, orari mësimor, frekuentimi, organizimi i klasave, grupeve, ambjentet mësimore etj.. (takimi me drejtuesit e fakultetit dhe të departamentit; takim me përfaqësuesit e Zyrës së Koordinimit dhe Mbarëvajtjes së Studentit) |

|  |   |                                     |                                    |   |
|--|---|-------------------------------------|------------------------------------|---|
| <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>                    | <p>Në fillim të çdo semestri, studentët njihen nga pedagogët e lëndëve me përmbajtjen e syllabuseve, me organizimin e lëndës në leksione/ seminare/ ushtrime/laboratore/detyra kursi, mënyrën e vlerësimit, literaturën e detyruar dhe atë të rekomanduar [Evidencë 2.3.d].</p> <p>Në takimin me stafin akademik u theksua puna që bëhej nga pedagogët për informimin e studentëve. Edhe studentët theksuan punën që bëjnë pedagogët për t'i sqaruar në lidhje me përmbajtjen e lëndës dhe organizimin e saj. Nga ana tjetër për çdo paqartësi studentët i drejtoheshin departamentit, i cili merrte masat për zgjidhjen e problemit.</p> |                                     |                                    |   |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>  | <p>Institucioni përmes Zyrës së Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët (ZKMS) dhe Zyrës së Karrierës dhe Alumnit (ZKA) informon vazhdimisht studentët mbi mundësitë e punësimit, organizon aktivitete të ndryshme orientuese dhe këshilluese (panairin e punës) [Evidencë 5.1.a,b], mbështet studentët në aplikimet e tyre, mundëson aplikime për punësim në kompani të ndryshme, me të cilat Institucioni bashkëpunon [Evidencë 5.5] etj.</p> <p>Pedagogët në diskutime me studentët u japin informacion studentëve në lidhje me kompetencat që fitojnë studentët në këtë program studimi dhe mundësitë që kanë për punësim.</p>      |                                     |                                    |   |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p> | <p>Institucioni vë në dispozicion të studentëve në ambjentet e Universitetit, në sekretarinë <i>online</i> dhe në faqen e tij <i>web</i>, të dhëna mbi orarin, aktivitete të ndryshme kurrikulare dhe ekstrakurrikulare, si dhe çdo informacion tjetër në funksion të mbarëvajtjes së procesit mësimor.</p>   |                                     |                                    |   |
| <p><b>Kriteri 5</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.</p>           | <p>I gjithë informacioni i nevojshëm për studentin në lidhje me programin e studimit, orari, struktura mësimore, aktivitetet kurrikulare, etj është i aksesueshëm nga studenti edhe online.</p> <p>Syllabuset u vihen në dispozicion studentëve me fillimin e semestrit.</p>  |                                     |                                    |   |
| <p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>  | <p><b>Nuk përmbushet</b></p>  | <p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p> | <p><b>Përmbushet kryesisht</b></p> | <p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p> |

|  |   |
|--|---|
| <p><b>Standardi V.4</b><br/> <b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm</b></p> |   |
| <p><b>Kriteret</b></p>   | <p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>  |
| <p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.</p>   | <p>Në sekretarinë mësimore mbahet regjistri i të diplomuarve, në të cilin regjistrohen të diplomuarit në vite sipas programeve të studimit. Në periudhën 2017-2019 janë diplomuar 40 studentë, nga të cilët numri i të punësuarve në përputhje me diplomën është 11</p> |

|   | dhe jo në përputhje me diplomën është 9. Një pjesë e madhe e studentëve synojnë të vazhdojnë studimet në ciklin e dytë.   |                              |                             |                              |                                   |                  |               |           |    |      |            |    |      |           |    |      |           |    |     |
|---|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|-----------------------------------|------------------|---------------|-----------|----|------|------------|----|------|-----------|----|------|-----------|----|-----|
| <b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. | Institucioni mirëmban regjistrin themeltar, ku janë të regjistruar studentët në vite, si studente të regjistruar për herë të parë, ashtu edhe ata të transferuar nga universitete të tjera. Në regjister hidhen të gjitha të dhënat në lidhje me progresin akademik të studentëve, që nga pranimi deri në diplomim, ata që janë larguar apo që përsërisin vitin.  |                              |                             |                              |                                   |                  |               |           |    |      |            |    |      |           |    |      |           |    |     |
|   | <table border="1"> <thead> <tr> <th>Numri i studentëve të regjistruar</th> <th>Per here të parë</th> <th>Nota mesatare</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2017-2018</td> <td>13</td> <td>7.29</td> </tr> <tr> <td>2018 -2019</td> <td>30</td> <td>7.01</td> </tr> <tr> <td>2019-2020</td> <td>21</td> <td>7.27</td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td>30</td> <td>7.8</td> </tr> </tbody> </table>  |                              |                             |                              | Numri i studentëve të regjistruar | Per here të parë | Nota mesatare | 2017-2018 | 13 | 7.29 | 2018 -2019 | 30 | 7.01 | 2019-2020 | 21 | 7.27 | 2020-2021 | 30 | 7.8 |
| Numri i studentëve të regjistruar   | Per here të parë  | Nota mesatare                |                             |                              |                                   |                  |               |           |    |      |            |    |      |           |    |      |           |    |     |
| 2017-2018   | 13  | 7.29                         |                             |                              |                                   |                  |               |           |    |      |            |    |      |           |    |      |           |    |     |
| 2018 -2019  | 30  | 7.01                         |                             |                              |                                   |                  |               |           |    |      |            |    |      |           |    |      |           |    |     |
| 2019-2020   | 21  | 7.27                         |                             |                              |                                   |                  |               |           |    |      |            |    |      |           |    |      |           |    |     |
| 2020-2021   | 30  | 7.8                          |                             |                              |                                   |                  |               |           |    |      |            |    |      |           |    |      |           |    |     |
|   | [Evidencë 1.1.a, fq. 13, Evidencë 1.1.b, fq. 14].   |                              |                             |                              |                                   |                  |               |           |    |      |            |    |      |           |    |      |           |    |     |
| <b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.  | Institucioni mban një regjister me rezultatet akademike të studentit nga moment i regjistrimit deri në diplomim. Regjistrat ishin të plotësuar në vazhdimësi.   |                              |                             |                              |                                   |                  |               |           |    |      |            |    |      |           |    |      |           |    |     |
| <b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.   | Sekretaria mësimore është përgjegjëse për ruajtjen, menaxhimin dhe përpunimin e të dhënave që lidhen me studentët. Sistemi i menaxhimit të tyre është i sigurtë dhe lehtësisht i aksesueshëm nga personat e autorizuar.   |                              |                             |                              |                                   |                  |               |           |    |      |            |    |      |           |    |      |           |    |     |
| <b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.                                    | Institucioni në mënyrë periodike harton raporte mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve [Evidencë 1.1.a, fq. 13, Evidencë 1.1.b, fq. 14], si dhe shkallën e punësimit të studentëve. Në rastet kur vihen re problematika lidhur me këto tregues, ndërmerren masa për përmirësimin e tyre. Këto të dhëna i përcillen ministrisë përgjegjëse për arsim me kërkesë të saj.<br><br>Në raportet e analizën vjetore të departamentit, ndërmjet të tjerave, analizohen të dhënat statistikore mbi cilësinë e studentëve gjatë viteve. |                              |                             |                              |                                   |                  |               |           |    |      |            |    |      |           |    |      |           |    |     |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>  | <b>Nuk përmbushet</b>   | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |                                   |                  |               |           |    |      |            |    |      |           |    |      |           |    |     |
|   |   |                              |                             | <b>X</b>                     |                                   |                  |               |           |    |      |            |    |      |           |    |      |           |    |     |

### Standardi V.5

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre**

| Kriteret   | Vlerësimi i ekspertëve   |
|--|--|
| <b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e | Përfaqësuesit e studentëve janë prezent në mbledhjet e departamentit [Evidencë 3.6] dhe në grupet e vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit. Ata, gjithashtu, shprehin mendimet dhe kërkesat e tyre edhe përmes përfaqësuesve në Këshillin Studentor. Kryetari i Këshillit |

|  |  |
|--|--|
| <p>këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>   | <p>Studentor është pjesë e Senatit Akademik [Evidencë 1.6, Neni 19, pika 6, fq. 11].</p>   |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>   | <p>Nga takimi me studentet, doli qe organizimet studentore funksiononin dhe nëpërmjet tyre studentët përcillnin zërin dhe shqetësimet e tyre në organet drejtuese të universitetit, departament, fakultet, senatin akademik.</p> <p>Studentet e quanin frutdhënëse rolin e përfaqësuesve në Këshillin studentor.</p>   |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p> | <p>Institucioni, gjatë hartimit të programeve të reja të studimit dhe rishikimit të programeve ekzistuese, kujdeset në plotësimin e standardeve të përcaktuara në udhëzimet përkatëse mbi ngarkesën akademike të studentëve në auditor [Evidencë 2.5]. Ngarkesa e studentit jashtë auditorit përbën më shumë se 50% të orëve totale vjetore të parashikuara në planin mësimor.</p> <p>Institucioni kujdeset që procedurat e përparimit të studentëve përgjatë programit të studimit të jenë lehtësisht të aksesueshme dhe të realizueshme për ta. Institucioni bën njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme, konform me kuadrin ligjor në fuqi. Në rregulloren për regjistrimet dhe transferimet jepen kriteret dhe procedurat e njohjes të plotë apo të pjesshme të krediteve. Këto procedura zbatohen konkretisht. Grupi i vlerësimit shqyrtoi dosje të transferimeve dhe i gjeti ato konform me rregulloren</p> <p>Në çdo rast, stafi i zyrave përkatëse është në dispozicion dhe në mbështetje të studentëve për zgjidhjen e problematikave të ndryshme që mund të dalin gjatë studimeve të tyre.</p> |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>   | <p>Rishikimi i kurrikulave të programeve të studimit <i>Bachelor</i> në “Inxhinieri Kompjuterike” dhe <i>Bachelor</i> në “Teknologji Informacioni”, në Mars – Prill 2019, ka qenë edhe iniciativë e studentëve, të cilët shprehën propozimet e tyre në Senatin Akademik, përmes përfaqësuesit të tyre, atë vit Kryetar i Këshillit Studentor. Këto sugjerime dhe të tjera të dala nga bashkëbisedimet me studentët janë reflektuar në rishikimin e këtyre kurrikulave.</p> <p>Institucioni në vazhdimësi është i hapur dhe me vëmendje të veçantë për propozimet e studentëve.</p> <p>Në takimin me pedagogoet u dhane shembuj te përmirësimit te syllabusit dhe metodës së mësimdhënjes mbështetur ne sugjerimet dhe vështirësitë që haste studenti gjatë studimit.</p>   |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.</p>  | <p>Studenti ka të drejtë të njihet me tezën e provimit pas korigjimit pasi të bëhet edhe ç’sekretimi i tyre. Ai ka të drejtë të njihet me pikët totale të vlerësimit në tezë, si dhe me pikët në çdo rubrikë. Nëse studenti konstaton se ka rubrika të pakorigjuara apo pikë të pallogaritura në vlerësimin total, ai ka të drejtë të reklamojë provimin në një kërkesë me shkrim, e cila depozitohet pranë sekretarisë mësimore të programit të studimit përkatës,</p>  |

|  |  |                              |                             |                              |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
|  | <p>brenda 48 orëve nga shpallja e rezultateve [Evidencë H.1, Neni 23, pika 3, fq. 17].</p> <p>Pas reklamimit të provimit nga ana e studentit për arsyet e përmendura më lart, Dekani i Fakultetit përkatës ngre një komision <i>ad hoc</i> në përbërjen e të cilit bëjnë pjesë edhe pedagogët, të cilët kanë korrigjuar provimet.</p> <p>Vendimi lidhur me rivlerësimin e provimit merret brenda një jave nga dita e depozitimit të ankesës dhe i bëhet i njohur studentit nëpërmjet sekretarisë mësimore.</p> <p>Vendimi i bashkëlidhet proces-verbalit të provimit (fletës së provimit) [Evidencë H.1, Neni 23, pika 4 – 5 - 6, fq. 17].</p> |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b> | <b>Nuk përmbushet</b>  | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|  |  |                              |                             | <b>X</b>                     |

|  |   |
|--|---|
| <b>Standardi V.6</b>   |   |
| <b>Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët</b>   |   |
| <b>Kriteret</b>  | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>   |
| <b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.  | Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët [Evidencë 5.2] dhe Zyra e Karrierës dhe Alumnit [Evidencë 5.3] janë dy njësitë kryesore në shërbim të informimit të studentëve, krahas Departamentit dhe Sekretarisë mësimore.   |
| <b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.   | <p>Orientimi dhe këshillimi i studentëve nis me informimin e maturantëve mbi programet e studimit të ofruara, nën përgjegjësinë e Zyrës së Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve në bashkëpunim të ngushtë me departamentin, dhe vazhdon deri pas përfundimit të studimeve, nëpërmjet Zyrës së Karrierës dhe Alumnit.</p> <p>Institucioni përmes departamentit ofron udhëheqje dhe kujdestari (tutoriat) për studentët, gjatë gjithë periudhës së studimeve. Departamenti ndihmon studentët që hasin vështirësi për përvetësimin e lëndëve, apo plotësimin e detyrimeve të ndryshme të programit të studimit, nëpërmjet orëve të konsultimit të zhvilluara me pedagogët.</p> <p>Nga takimi me studentet, doli qe ndihma e pedagoqeve nëpërmjet konsultimeve dhe materialeve ndihmëse ishte e madhe.</p> |
| <b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në | <p>Institucioni përmes Zyrës së Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët dhe Zyrës së Karrierës dhe Alumnit informon vazhdimisht studentët mbi mundësitë e punësimit, organizon aktivitete të ndryshme orientuese dhe këshilluese [Evidencë 5.1.a,b], argëtuese [Evidencë 5.4.a,b,c], mbështet studentët në aplikimet e tyre, mundëson aplikime për punësim në kompani të ndryshme, me të cilat Institucioni bashkëpunon [Evidencë 5.5] etj.</p> <p>ZKA mbështet në mënyrë aktive të diplomuarit në planet e tyre për karrierën dhe përshtatjen me tregun e punës. Departamenti me mbështetjen e ZKA orienton studentët në përzgjedhjen e institucionit, pranë të cilit do</p>   |



|  |   |                              |                             |                              |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.  | të zhvillojnë praktikën mësimore. Praktikata mësimore zhvillohen në institucionet me të cilat “Albanian University” ka marrëveshje bashkëpunimi [Tabela 5].                               |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. | Zyra e Karrierës dhe Alumnit në mënyrë periodike azhuron të dhënat mbi punësimin e studentëve të diplomuar, i përpunon dhe ruan ato, dhe i bën të disponueshme për autoritetet drejtuese. |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>   | <b>Nuk përmbushet</b>   | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|  |   |                              |                             | <b>X</b>                     |

|   |                       |                              |                             |                              |
|---|-----------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b> | <b>Nuk përmbushet</b> | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|   |                       |                              |                             | <b>X</b>                     |

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

|  |  |
|--|--|
| <b>Standardi VI.1</b>  |  |
| <b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë</b>                                     |  |
| <b>Kriteret</b>  | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>  |
| <b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.   | “Albanian University” për sigurimin e brendshëm të cilësisë ka hartuar politika në nivel institucional, si dhe ka ngritur strukturat përkatëse deri në nivel njësie bazë, të cilat merren me monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, nëpërmjet përdorimit të instrumenteve të duhur.<br><br>Strukturat e ngritura dhe procedurat e ndjekura janë në përputhje me Kodin e Cilësisë në Republikën e Shqipërisë, si dhe me Manualin “Procedurat dhe afatet për vlerësimin e cilësisë në kuadër të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit”.  |
| <b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorët e ekspertët të jashtëm. | Në “Albanian University”, Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë funksionon që nga viti 2009 - 2010. Që nga ajo kohë, Universiteti për të institucionalizuar Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, me Vendim Senati Akademik, nr. 178 dt. 23/07/2010, ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë [Evidencë 6.1], si dhe në përputhje me ligjin 80/15 me Vendim Nr. 4 të Senatit Akademik dt. 22/12/2016 ka ngritur edhe Komisionin e Përhershëm për Vlerësim Institucional [Evidencë 6.2], pjesë e të cilit është edhe një student. Studentët, gjithashtu, janë të përfshirë si pjesë e grupit të punës në çdo rast kur institucioni realizon akreditimin institucional apo akreditimin e programeve të studimit, si dhe gjatë realizimit të pyetësorëve. Prej shtatorit të vitit 2016, |



|  |   |
|--|---|
|  | <p>në mbështetje të cilësisë në “Albanian University”, funksionon edhe grupi i sigurimit të cilësisë në nivel njësie bazë, ngritur me Vendim Senati Akademik Nr. 157/3 dt. 08/09/2016, anëtarët e të cilëve përditësohen çdo vit [Evidencë 6.3.a,b,c,d]. Institucioni i jep një rëndësi të veçantë sigurimit të cilësisë në çdo iniciativë akademike dhe për këtë arsye, politikat e sigurimit të cilësisë nuk paraqiten vetëm në strategjinë institucionale të Institucionit, por në mënyrë të detajuar në Strategjinë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë [Evidencë 6.4]. Bazuar në nevojat e Institucionit, si dhe në kuadër të marrjes së vendimeve sa më objektive dhe efikase, NjSBC bashkëpunon edhe me ekspertë të jashtëm, të angazhuar pranë tij: 1 konsulent juridik dhe 1 konsulent për zhvillimin dhe përmirësimin e kurrikulave [Evidencë 6.5.a,b].</p>   |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>  | <p>“Albanian University” në kuadër të sigurimit të cilësisë i kushton një rëndësi të veçantë rekrutimit të stafit akademik me tituj e grada shkencore, me eksperiencë në fushën përkatëse. Trajnimi i stafit akademik është një element i rëndësishëm i politikave të institucionit për ruajtjen dhe rritjen e mëtejshme të sigurimit të cilësisë. Zakonisht në fillim të vitit akademik, por edhe gjatë tij, realizohen trajnime me personelin akademik, në disa raste edhe me lektorë të huaj, për çështje të tilla që lidhen me teknologjitë e mësimdhënies, metodat bashkëkohore të mësimdhënies, etj. [Evidencë 3.9.a,b].</p> <p>Instrumentat e shumta, si pyetësorët me studentët, stafin akademik, fokus grupet, etj. shërbejnë për marrjen e një <i>feedback</i>-u me qëllim ndërhyrjen dhe përmirësimin e cilësisë nëse është e nevojshme. Gjithashtu, Institucioni në mënyrë periodike realizon vlerësimin e jashtëm institucional dhe atë të programeve të studimit, si dhe merr të gjitha masat për të plotësuar maksimalisht rekomandimet e lëna nga vlerësuesit e jashtëm dhe Bordi i Akreditimit.</p>  |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p> | <p>Politikat e përmirësimit të cilësisë së programeve të studimit paraqiten në strategjinë e zhvillimit institucional [Evidencë 1.4, fusha 4, fq. 17], si dhe në strategjinë e Sigurimit të Cilësisë së Institucionit. Konkretisht, në përfundim të vitit akademik grupi i sigurimit të cilësisë në nivel departamenti plotëson raportin e vetëvlerësimit të programit të studimit në të cilin paraqiten të dhëna për programin e studimit, ndryshimet e mundshme të realizuara, planet për ndryshimet dhe përmirësime në të ardhmen, <i>feedback</i>-u i marrë nga studentët, nga personeli akademik i përfshirë në programin e studimit, të dhëna mbi ecurinë e studentëve etj.. Ky raport është plotësuar për herë të parë gjatë vitit akademik 2018 – 2019, në formë pilot për disa programe studimi të Institucionit. Për Departamentin e Inxhinierive, është hartuar raporti i vetëvlerësimit për programin e studimit <i>Master Profesional</i> në “Sisteme të Energjisë” [Evidencë 6.6].</p> <p>Gjithashtu, në përfundim të semestrit të parë dhe në përfundim të vitit akademik njësi bazë harton një raport semestral dhe një raport vjetor, në të cilin përfshihen të dhëna përshkruese dhe sasiore mbi çështje që lidhen me gjendjen e programeve të studimit, vlefshmërinë e akreditimit, stafin akademik të rekrutuar, literaturën e re të hyrë në bibliotekë, rezultatet e</p> |

|  |   |                              |                             |                              |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
|  | arritura të studentëve, kalueshmëria dhe nota mesatare, marrëveshjet e bashkëpunimit, veprimtaria kërkimore shkencore dhe në fund paraqitet analiza SWOT, si dhe masat e marra për përmirësime në të ardhmen. |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b> | <b>Nuk përmbushet</b>   | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|  |   |                              |                             | <b>X</b>                     |

|   |   |
|---|---|
| <b>Standardi VI.2</b>   |   |
| <b>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</b> |   |
| <b>Kriteret</b>   | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>   |
| <b>Kriteri 1.</b> Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.   | Në “Albanian University”, janë ngritur Grupet e Sigurimit të cilësisë në nivel departamenti [Evidencë 6.3.a,b,c,d]. Këto janë grupe <i>ad-hoc</i> , të cilat përbëhen nga staf akademik i brendshëm i njësisë bazë, konkretisht 2 apo 3 pedagogë me tituj e me grada, të cilët punojnë për rishikimin e kurrikulave dhe syllabuseve, në bashkëpunim me lektorët e lëndëve, hartimin e raportit të vetëvlerësimit për programin e studimit, si dhe janë pjesë e grupeve të vlerësimit të brendshëm në rastet e akreditimit të programeve të studimit.  |
| <b>Kriteri 2.</b> Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.                                 | <p>Çdo fillim viti akademik bëhet përditësimi i syllabuseve nga titullarët e lëndës në bashkëpunim me lektorët e lëndëve dhe asistent-lektorët. Ky aktivitet zhvillohet nën kujdesin e Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave, dhe me Grupin e Sigurimit të Cilësisë në nivel Departamenti.</p> <p>Për rishikimin e programeve të studimit, në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm, në përputhje me nevojat e diktuar nga studimi i tregut të punës, Departamenti ngre grupin e punës <i>ad-hoc</i>, [Evid.6.11] dhe ndjek procedurën përkatëse për miratimin e tij, të shprehur në Rregulloren për mbarëvajtjen e kurrikulave dhe procesit mësimor në “Albanian University” [Evidencë Nr. 6.7, neni 9, fq. 4]. Në grupin e ekspertëve mund të përfshihet edhe grupi i sigurimit të cilësisë së departamentit</p> <p>Në vendimet për ngritjen e grupeve të ekspertëve, [Evid.6.11] u konstatua se në përbërje të grupit kishte personel akademik efektiv dhe personel akademik me kontratë. Gjithashtu në grupin e ekspertëve kishte përfaqësues nga bota e biznesit. Personeli akademik, i përfshirë, ishte përgjithsisht me gradë shkencore, por figuronin edhe me diplomë Master i Shkencave.</p> <p><i>Duke qenë se grupet e punës janë Ad-hoc, dhe grupi i sigurimit të cilësisë emërohet çdo vit, rekomandohet që programet e studimit të kenë nje koordinator, i cili të jetë përgjegjës për mbikqyrjen e herë pas hershme të programit të studimit.</i></p> <p><i>Për miratimin e përmbajtjes së syllabuseve, rekomandojme qe te behen nga seksionet e grup-lendeve. Strukturat e tjera, si zyra e</i></p> |

|   |  |
|---|--|
|   | <i>Zhvillimit kurrikular, NJSBC, Komisioni për kurrikulat dhe mësimin nuk mund të analizojnë përmbajtjen e syllabuseve</i>   |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>     | <p>Për monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit përdoren disa metoda:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Pyetësorë të studentëve [Evidencë 3.4],</li> <li>▪ Fokus grupe (në muajin dhjetor), mbi vlerësimin e mësimdhënies, procesit mësimor, infrastrukturës, etj. [Evidencë 6.8],</li> <li>▪ Raporte vetëvlerësimi të pedagogëve [Evidencë 3.5],</li> <li>▪ Raport vetëvlerësimi për programin e studimit [Evidencë Nr.6.6],</li> <li>▪ Raporte semestral dhe vjetor për vlerësimin e punës së departamentit [Evidencë 1.1.a,b,c].</li> </ul> <p>Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë organizon sondazhet me studentët 2 herë në vit si dhe fokus grupet me studentët në muajin dhjetor. Fokusi i këtyre sondazheve është cilësia e mësimdhënjes dhe evidentimi i problematikave që kanë studentët.</p> <p>Në departament raportohet nga pedagoget, në përfundim të semestrit, në lidhje me arritjen e objektivave të lëndës dhe problematikave që dalin. Në departament bëhet edhe analiza semestrale dhe vjetore e veprimtarisë së departamentit, ku një vend të rëndësishëm zen edhe vlerësimi i programeve të studimit.</p> <p>Nga grupi i cilësisë së departamentit hartohet një raport vetëvlerësimi i programit të studimit. Kjo është një praktikë e re që është implementuar së fundmi në formën e një projekti pilot, për disa programe studimi</p> |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p> | <p>Rezultatet e vlerësimeve të realizuara nga NJSBC dokumentohen në formë shkresore dhe i dërgohen të gjitha instancave përkatëse. Kështu, pas realizimit të focus grupeve, informacioni i dërgohet Rektoratit dhe cdo njësi bazë me qëllim marrjen e masave për përmirësim të mundshme në të ardhmen. Gjithashtu, pas mbledhjes dhe analizimit të të dhënave nga pyetësorët e studentëve, informacioni dërgohet në departament, i cili i diskuton në mbledhje të posatshe dhe ia komunikon në mënyrë konfidenciale personelit akademik. Për më tepër, të dhënat e mbledhura nga pyetësorët e studentëve diskutohen edhe në mbledhje të Senatit Akademik.</p> <p>Të gjitha të dhënat e mbledhura në mënyrë periodike gjatë vitit akademik pasqyrohen në raportet vjetore duke filluar nga Njësia Bazë e duke vazhduar deri në Instancat më të larta akademike dhe administrative (Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit) për t'u dërguar pastaj në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe bëhen publike në faqen zyrtare të Institucionit</p> <p><a href="https://albanianuniversity.edu.al/sq/sigurimi-i-brendshem-i-cilesise/">https://albanianuniversity.edu.al/sq/sigurimi-i-brendshem-i-cilesise/</a></p>   |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e</p>                                     | <p>Në raportin e vlerësimit të hartuar nga departamenti, [Evid.1.1] përfshihen të dhëna përshkruese dhe sasiore mbi çështje që lidhen me</p>   |

|  |   |                              |                             |                              |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë. | gjendjen e programeve të studimit, që mbulon departamenti, vlefshmërinë e akreditimit, stafin akademik të rekrutuar, literaturën e re të hyrë në bibliotekë, rezultatet e arritura të studentëve, kalueshmëria dhe nota mesatare, marrëveshjet e bashkëpunimit, veprimtaria kërkimore shkencore dhe në fund paraqitet analiza SWOT, si dhe masat e marra për përmirësime në të ardhmen. |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>                             | <b>Nuk përmbushet</b>   | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|  |   |                              |                             | <b>X</b>                     |

| <b>Standardi VI.3</b>   |  |
|---|--|
| <b>Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve</b>   |  |
| <b>Kriteret</b>   | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>  |
| <b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.                  | <p>Në kuadër të akreditimit të programeve të studimit, departamenti i inxhinierisë kryen në mënyrë periodike (çdo tre vjet), vlerësimin e brendshëm të programit të studimit, si pjesë e procesit të riakreditimit. Këto raporte dorëzohen në Njësinë e sigurimit të cilësisë për t'u bërë pjesë e vetvlerësimit të brendshëm të institucionit.</p> <p>Gjatë vitit akademik 2018–2019 grupi i sigurimit të cilësisë në departament, në zbatim të një projekti pilot të ndërmarrë nga Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë, ka hartuar për herë të parë, një raport vetvlerësimi të programit të studimit <i>Master Profesional</i> në “Sisteme të Energjisë” [Evidencë 6.6]. Raporti është vjetor dhe i përcillet Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, si dhe Njësisë Bazë përkatese, e cila këtë informacion duhet ta përfshijë në raportin vjetor të departamentit.</p> <p>Nga shqyrtimi i këtyre dy raporteve, gjykoj se ka mbivendosje të raportimeve. Për më tepër Grupi i cilësisë i departamentit i përbërë nga 2 persona, duhet të hartojë çdo vit 8 raporte vetvlerësimi për të gjitha programet e studimit që mbulon.</p> |
| <b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.   | <p>Departamenti i Inxhinierive përveç vlerësimeve në rang Institucioni, angazhohet në vlerësimin e programeve të studimit dhe ofertës akademike me metoda dhe instrumenta specifike të fushës.</p> <p>Në mënyrë të vazhduar, edhe si pjesë studimesh kërkimore – shkencore të stafit akademik, Departamenti i drejtohet studentëve për të marrë <i>feedback</i> për problematika të ndryshme, të cilat prekin drejtëpërdrejtë programet e studimit të ofruara [Evidencë 6.9].</p>  |
| <b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor | <p>Pjesë e metodave të vlerësimit janë edhe vlerësimet e drejtëpërdrejta nëpërmjet nxjerrjes së statistikave të kalueshmërisë së studentëve, notës mesatare, rishikimit të vazhdueshëm të programeve mësimore për secilën lëndë si dhe rishikimit të kurrikulave, në përputhje me aktet ligjore në fuqi, kërkesat e tregut të punës, apo edhe kërkesave të personelit akademik, apo studentëve kur vlerësohet si e domosdoshme.</p> <p><b>Rekomandohet që të zgjerohen fasha e metodave të drejtpërdrejta për vlerësimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimit me</b></p>  |

|   |   |                                     |                                    |                                     |
|---|---|-------------------------------------|------------------------------------|-------------------------------------|
| <p>gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e e rregulluara dhe të tjera.</p>  | <p><i>vlerësimin e cilësisë në mësimdhënje, vlerësimin e didaktikës, vëzhgimeve në auditor, etj</i></p>   |                                     |                                    |                                     |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p> | <p>Pyetësorët dhe fokus grupet e realizuara me studentët aktualë janë periodike, dy herë në vit pyetësorë dhe një herë në vit fokus grupe. Ndërkohë, “Albanian University” në vitin akademik 2018 - 2019 ka realizuar për herë të parë edhe një pyetësor me personelin akademik, për të marrë përshtypjet e tyre në lidhje me çfarë i ofron Institucioni dhe sa të kënaqur janë ata. Gjithashtu, Zyra e Karrierës dhe Alumnit mban kontakte të vazhdueshme me Alumn-it e “Albanian University”.</p> <p><i>Rekomandohet që të zgjerohen fasha e metodave të tërthorta për vlerësimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimit, duke marrë mendimet dhe opinionet e palëve të tjera, të interesuar për dijet dhe kompetencat e fituara në programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike.</i></p> |                                     |                                    |                                     |
| <p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>   | <p><b>Nuk përmbushet</b></p>  | <p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p> | <p><b>Përmbushet kryesisht</b></p> | <p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> |
|   |   |                                     |                                    | <p><b>X</b></p>                     |

|   |   |
|---|---|
| <p><b>Standardi VI.4</b><br/> <b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre</b></p>        |   |
| <p><b>Kriteret</b></p>  | <p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>  |
| <p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p> | <p>Në dokumentacionin e NJSBC, “Strategjia për sigurimin e cilësisë në AU” dhe Rregullore për organizimin dhe funksionimin e NJSBC”, [Evidencë 6.10, Evidence 6.4] shprehet politika e AU për përfshirjen e aktorëve të brendshëm e të jashtëm në procedurat e brendshme të cilësisë. Kështu në Komisionin e Vlerësimit Institucional një antar zgjidhet nga rradhët e studentëve. Në grupin e hartimit të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm të programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike ishte përfshirë një ekspert i jashtëm për sigurimin e cilësisë si dhe një përfaqësues i studentëve</p> |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>     | <p>Në rregulloren e NJSBC janë të parashikuara detyrat e palëve të përfshira në çështjet e cilësisë [Evidencë Nr. 6.10], si detyrat e Komisionit të Vlerësimit Institucional, Njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë, Grupit të cilësisë pranë departamenteve, grupit të hartimit të raporteve të vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit dhe të vlerësimit institucional.</p>   |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe</p>  | <p>Në procedurat e vlerësimit të cilësisë marrin pjesë të gjithë aktorët, të cilët kanë një ndikim të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë në realizimin e programit të studimit. Njësia bazë, personeli akademik dhe</p>   |



|  |   |                              |                             |                              |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.  | administrativ, si dhe studentët, luajnë një rol të rëndësishëm bashkëpunues me strukturat e sigurimit të cilësisë në nivel institucional.<br><br>Në rregulloren e NJSBC janë përcaktuar raportimet për sigurimin e cilësisë që bëhen nga personeli akademik, përgjegjësit e njësisë bazë dhe njësisë kryesore, grupet e cilësisë së njësisë bazë, perfshirja e gjykimit të studentëve në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënjes, etj.  |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.   | Institucioni respekton të drejtat themelore të çdo pale të përfshirë në jetën universitare, si dhe respekton Kodin e Etikës të “Albanian University”.<br><br>Ngritja e grupit të vlerësimit të brendshëm bëhet mbi bazën e shmangies të konfliktit të interes me postin që ata mbajnë.  |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj. | Në kuadër të vlerësimeve periodike të programeve të studimit, një vëmendje e veçantë i kushtohet sugjerimeve dhe rekomandimeve të lëna nga ekspertët e jashtëm. Gjithashtu, në fazën e rishikimit të programeve të studimit, brenda masës së lejuar deri në 20%, Institucioni herë pas herë angazhon edhe ekspertë të jashtëm [Evidencë 6.11].<br><br>Në grupin e punës për realizimin e raportit të vlerësimit të brendshëm të programit të studimit bënte pjese edhe një ekspert i jashtëm. |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>   | <b>Nuk përmbushet</b>   | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|  |   |                              |                             | <b>X</b>                     |

|   |   |
|---|---|
| <b>Standardi VI.5</b>   |   |
| <b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë</b>                 |   |
| <b>Kriteret</b>   | <b>Vlerësimi i ekspertëve</b>   |
| <b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. | “Albanian University” në përfundim të cdo viti akademik në perputhje me udhëzimin Nr. 5 dt. 18/02/2018, dërgon pranë MASR raportin vjetor të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore – shkencore të Institucionit, si dhe e bën publike për të gjithë të interesuarit në faqen web<br><br><a href="https://albanianuniversity.edu.al/sq/sigurimi-i-brendshem-i-cilesise/">https://albanianuniversity.edu.al/sq/sigurimi-i-brendshem-i-cilesise/</a> |
| <b>Kriteri 2.</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.  | Raporti vjetor i veprimtarisë mësimore dhe kërkimore – shkencore të institucionit përfshin të dhëna të përmbledhura statistikore për secilin program studimi, duke ruajtur dhe respektuar lirinë dhe etikën akademike.  |
| <b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.  | Raporti vjetor i departamentit përfshin të dhëna mbi masat e marra nga planveprimi i vitit të kaluar dhe planin e veprimit për vitin e ardhshëm akademik.   |
| <b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e  | I gjithë procesi i monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë synon përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit   |



|   |  |                                     |                                    |                                     |
|---|--|-------------------------------------|------------------------------------|-------------------------------------|
| <p>veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>   | <p>“Bachelor në Inxhinieri Mekatronike”. Grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton se ka një ndryshim cilësor në këtë drejtim, krahasuar me vlerësimin e parë të bërë këtij program studimi. Drejtuesit e njësisë bazë, njësisë kryesore dhe të institucionit kanë bërë përpjekje serioze për përmirësimin e cilësisë së këtij program studimi.</p> <p>Nga analiza e bërë më rezulton se një pjesë e masave të marra kanë qenë efektive dhe kanë dhënë rezultat. Megjithatë, duhet të theksojmë, se jo çdo përpjekje e bërë ka dhënë frutet e veta positive. Ne nuk kemi pare në raportimin vjetor të departamentit një analize të matjes së efektivitetit të veprimeve të ndërmarra, përveçse një analize swot. Departamenti duhet të analizojë më mire shkaqet e dështimit në zbatimin e planit të masave, për të bërë të mundur planifikimin e masave për të zbutur ose eliminuar shkaqet.</p> <p><i>Rekomandohet që në raportimet vjetore, departamenti të bëjë një vlerësim të efektivitetit të masave të marra për përmirësimin e programit të studimit.</i></p> |                                     |                                    |                                     |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p> | <p>Institucioni në fillim të çdo viti akademik në javët orientuese, si dhe pas çdo procesi të vlerësimit të jashtëm, informon studentët dhe stafin akademik mbi rëndësinë e vlerësimit të cilësisë dhe akreditimit të programeve të studimit. Avantazhet dhe disavantazhet që kanë këta të fundit nga vlerësimi cilësor dhe akreditimi i programeve të studimit dhe vlerësimi institucional.</p>   |                                     |                                    |                                     |
| <p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>   | <p><b>Nuk përmbushet</b></p>   | <p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p> | <p><b>Përmbushet kryesisht</b></p> | <p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> |
|   |  |                                     |                                    | <p><b>X</b></p>                     |
| <p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b></p>   | <p><b>Nuk përmbushet</b></p>   | <p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p> | <p><b>Përmbushet kryesisht</b></p> | <p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> |
|   |  |                                     |                                    | <p><b>X</b></p>                     |

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Inxhinieri Mekatronike” të Universitetit Privat “Albanian University”**

**Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Programi i studimit *Bachelor* në “Inxhinieri Mekatronike” është në përputhje me misionin, strategjinë e institucionit, fushën akademike të departamentit dhe ndjek nevojat e tregut të punës kombëtar dhe ndërkombëtar. Departamenti i Inxhinierive kryen rishikimin e kurrikulave mbështetur në studimin e vazhdueshëm të tregut të punës.
2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit i Institucionit, ka shërbyer për administrimin, informimin dhe monitorimin e aktivitetit akademik, financiar e administrativ të programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike. I gjithë procesi i rishikimit të këtij programi studimi dhe sigurimi i cilësisë së tij është kryer konform me procedurat dhe rregulloret e brendshme të institucionit.

3. Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira. Institucioni ka vënë në dispozicion të departamentit të Inxhinierive, infrastrukturën e nevojshme për realizimin e këtij program studimi, e cila mirëmbahet dhe përmirësohet në vazhdimësi. Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën me literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies.
4. Departamenti ka zgjeruar rrjetin e bashkepunimit me Institucione të tjera të Arsimit të Lartë, brenda dhe jashtë vendit, rrjete akademike, si dhe me aktorë të biznesit, të cilët ndikojnë në arritjen e objektivave të programit të studimit.
5. Departamenti i Inxhinierive është i angazhuar në kërkim shkencor në drejtim të përdorimit të Teknologjive të Informacionit në mësimdhënie. Departamenti i Inxhinierive organizon në vazhdimësi konferencën Studentore “Inovacion në Inxhinieri, Shkencë dhe Teknologji”, ku studentët prezantojnë studime dhe realizime praktike në fushat inxhinierike që mbulon.
6. Institucioni ka njësi të posaçme dhe procedura për orientimin dhe këshillimin e studentëve, të cilat operojnë në vazhdimësi dhe përdoren nga studentët. Institucioni përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe sigurimit të cilësisë së tyre.

#### **Pika të dobta:**

1. Në Departamentin e Inxhinierive, ngarkesa e personelit akademik efektiv dhe numri i moduleve/lendëve që mbulon një pedagog është shumë e lartë, krahasuar me normat e përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi. Mesatarisht, ngarkesa është 553.4 ore në auditor dhe numri i moduleve për 1 pedagog 7.8 lëndë.
2. Megjithë përpjekjet e bëra, Departamenti i Inxhinierive nuk ka kapërcyer pengesat për kualifikimin e personelit akademik efektiv pa grade shkencore. Kjo e bën të brishtë plotësimin në vijimësi të standardeve akademike në lidhje me numrin e personelit akademik me tituj e grada që duhet të ketë departamenti dhe për mbulimin e programeve të studimit që ofrohen.
3. Departamenti i Inxhinierive administron 8 (tetë) programe studimi në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve. Departamenti nuk kishte përcaktuar koordinatorët e programeve të studimit

#### **Rekomandime:**

1. Grupi i vlerësimit të jashtëm rekomandon që të vendosen koordinatorët e programeve të studimit, të cilët do të jenë përgjegjës për zhvillimin e programit dhe të praktikave profesionale.
2. Ekspertët rekomandojnë që për të patur një stabilitet të ngarkesës në auditor të sigurohet nga plani mësimor, Senati Akademik i “Albanian University” të shndërrojë në standarde institucionale raportet kredit/orë në auditor për të gjitha aktivitetet formuese të lëndëve inxhinierike.
3. Grupi i ekspertëve të jashtëm sugjeron që për të forcuar përgatitjen teorike, në mënyrë që studenti të marrë njohuri të thelluara teorike për vijimin e studimeve në ciklet e tjera, është mirë të shtohet fondi i orëve në auditor për leksionet, duke j’u afruar atyre të përdorura për programe studimi të ciklit të parë, në fushat inxhinierike, në universitet kombëtare dhe rajonale duke respektuar gjithmonë standardin që orët në auditor të mos e kalojnë gjysmën e fondit total të orëve. Lëndët inxhinierike kanë nevojë për spjegime dhe interpretime të koncepteve dhe njohurive shkencore nga ana e pedagogut.

4. Universiteti Albanian University është mirë të vendosë standarde të brendshme në lidhje me ngarkesën maksimale që mund të realizojë një personel akademik efektiv dhe një personel akademik me kontratë.
5. Institucioni duhet të investojë dhe të shfaqë një buxhet për kualifikimin e mëtejshëm të personelit akademik, me qëllim përfundimin e gradave akademike.
6. Miratimi i përmbajtjes së syllabuseve të behet nga seksionet e grup-lendeve. Strukturat e tjera, si zyra e Zhvillimit kurrikular, NJSBC, Komisioni për kurrikulat dhe mësimin nuk mund të analizojnë përmbajtjen e tyre.
7. Rekomandohet që të zgjerohen fasha e metodave të drejtpërdrejta dhe të tërthorta për vlerësimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimit nëpërmjet vlerësimit të mësimdhënjes dhe metodave të përdorura, vëzhgimeve në auditor, marrja e mendimeve dhe opinionëve të palëve të interesuar për dijet dhe kompetencat e fituara në programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike.

### **Conclusions of the periodic Evaluation of the study program of the first cycle Bachelor in "Mechatronic Engineering" of the Private University "Albanian University"**

#### **Strengths:**

1. Department of Engineering in the "Albanian University" has developed "Mechatronic Engineering" as a teaching program for bachelor degree. This program is based on department mission and on institution strategy. This program is part of the academic field for this department and follows needs and national and international interest in labour market. The curriculum was reviewed based on, labour market research.
2. The internal management system of "Albanian University" has served for the administration, information and monitoring of the academic, financial and administrative activity of the Bachelor study program in Mechatronic Engineering. The whole process of reviewing this study program and quality assurance is carried out in accordance with the internal procedures and regulations of the institution.
3. The institution guarantees teaching and learning in a professional way. Institution guaranty professional and scientific trainings based on the best methods and practices. Department of Engineering has all necessary infrastructures, for implementation of this study program. Department has continuously improved this study program. The institution has made available for the students all learning environments. The library is equipped with necessary literature in support of this learning program.
4. The Department has expanded cooperation with other higher education institutions, which are inside and outside of Albanian country. Department is member of academic networks. Department has created connection with companies which are operating in Mechatronic industry. All these factors had influenced in the achievements of the objectives for this study program.
5. The Department of Engineering is engaged in the scientific researches which intend to use Information Technologies in educational system. It is necessary to mention, some of these technologies are successfully practiced with students. The Department of Engineering continuously organizes a Student Conference called "Innovation in Engineering, Science and Technology". In this conference students present their studies and their practical achievements for engineering fields they which are involved.
6. The institution has an office which is responsible for the student's progress. This office is a support for the students of the university. In this office students receive guidance and counselling. The institution involves and engages students in decision-making and advisory bodies in the framework of drafting, approving, reviewing and improving study programs, teaching methods and quality assurance.

## Weaknesses:

1. In the Department of Engineering, the workload for full time staff is very high, also the number of teaching modules / subjects which this staff is obligated to cover is very high. These compared with norms set out bylaws in force. On average, the load is 553.4 hours in the auditorium and the number of modules per lecturer is 7.8 subjects.
2. Despite the efforts made, the Department of Engineering has not overcome the obstacles related to the qualification of the academic personnel. These qualifications are related with scientific degrees and research. These obstacles make Department and the program fragile and give hard work to achieve the academic standards related to the number of qualified academic staff of the Engineering department that needs to cover topics for all study programs which are offered.
3. The Department of Engineering administers 8 (eight) study programs in the first and second cycle of studies, but the department did not delegate coordinators for each study program.

## Recommendations:

1. The external evaluation team recommends: Department must elect coordinators for each study program. These coordinators will be responsible for the controlling and continues development of the study program and professional practices.
2. Experts recommend that Academic Senate of "Albanian University" must convert ETC credits / per hours reported in auditorium, for all teaching activities. This conversion must be standard for all engineering curricula's and must be shown in university regulation.
3. The University Albanian University needs to apply internal standards regarding the maximum teaching hours (workload) that can be achieved by internal academic staff and a by external academic staff.
4. The group of external experts suggests that university must increase the number of hours for lectures in the auditorium. By increasing number of hours' students gain strengthen the theoretical preparation. They also depth their theoretical knowledge and are capable for continuing studies in other cycles of the engineering curricula. University always must respect the standard that the hours in the auditorium must not exceed half of the total fund of hours. The engineering courses need very good explanations and interpretations of theoretical scientific and concepts from lecturer.
5. The institution must invest and present a budget for the further qualification of the academic staff because is very important for them to obtain academic degrees.
6. Approval of the content of the curricula should be done by the sections of group-subjects. Other structures, such as the Curriculum Development Office, the Internal Quality Assurance Unit (IQAU), the Curriculum and Learning Commission, cannot analyse their content.
7. It is recommended to expand direct and indirect methods which are used for quality assessment. These methods help university on the implementation of study programs. Through the evaluation of teaching methods used, and through observations in the auditorium, University will obtain opinions for acquired competencies, also for transmission of knowledge from professor to student during teaching of Mechatronics in Bachelor degree.

### Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

| FUSHAT E VLERËSIMIT  | SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS |                       |                      |                       |
|--|--|-----------------------|----------------------|-----------------------|
|  | Nuk përmbushen                                 | Përmbushen pjesërisht | Përmbushen kryesisht | Përmbushen plotësisht |
| I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT |  |                       |                      | X                     |
| II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT       |  |                       | X                    |                       |
| III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT       |  |                       |                      | X                     |
| IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT             |  |                       |                      | X                     |
| V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE                             |  |                       |                      | X                     |
| VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE                       |  |                       |                      | X                     |
| VLERËSIMI TËRËSOR  |  |                       |                      | X                     |